REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIC OF KOSOVA-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS-MALISHEVË
THE MUNICIPAL ASSEMBLY-MALISHEVË-SKUPŠTINA OPŠTINE MALIŠEVO

PRANUAR MË:
ACCEPTED ON: 19/10/2026
PRIMLJENO:
Nr.No.Br. 02/305

REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË

Kuvendi Komunal Malishevë

PROCESVERBAL

i mbledhjes së **VI** (gjashtë) të Kuvendit Komunal të Malishevës, mbajtur, më 29.09.2026

Të pranishëm në fillim të mbledhjes ishin: **23** anëtarë të Asamblesë, Kryesuesi i Kuvendit, Kryetari i Komunës, *z.Ekrem Kastrati*, drejtori për Administratë të Përgjithshme, *z.Argjend Thaçi,* drejtori për Urbanizëm, *z.Avdi Morina*, drejtori për Shërbime Publik, *z.Izet Hoti*, drejtoresha për Kulturë, Rini dhe Sport, *znj.Teuta Miftari Mazreku,* drejtori për Mbrojtje dhe Shpëtim, *z.Nuredin Hoxha,* drejtori për Ekonomi dhe Financa, *z.Blerim Thaçi*, drejtori i Inspektoriatit *z.Jakup Gashi,* drejtori për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, *z.Amrush Helshani*, drejtori për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvilllim Rural, *z.Sylë Dukolli*, drejtori për Zhvillim Ekonomik dhe Turizëm *z.Arbër Kastrati,* drejtoresha për Prona, *znj.Mirlinda Gashi*, Sami Behrami, udhëheqës i sektorit të zonave për mbojtjen e natyrës, zyrtari ligjor, *z.Muharrem Morina*, si dhe zyrtar nga Zyra e Informimit.

Mbledhjen e udhëhoqi Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Malishevës, *z.Fatmir Ademaj.*

Fatmir Ademaj, Kryesues i Kuvendit:
Përshëndetje për të gjithë! Mirë se keni ardhur në mbledhjen e gjashtë të rregullt të Kuvendit Komunal të Malishevës, *hapim debatin deklarime jashtë rendit të ditës.*

Veton Zogaj, (GP. LVV): Përshëndetje për të gjithë! Unë kohët e fundit i kam pranuar disa kërkesa nga qytetarët, por do ti ceku vetëm tri më kryesore: në seancën e fundit ne e kemi marrë një vendim për ndërtimin e depozitimit të ujit nga kompania e "Hidroregjion-it", dhe kryetari është zotuar se të gjitha mjetet do të përdoren për të arritur ky projekt. Këtë vendim e ka konfirmuar edhe MAPL-ja si të ligjshme, por ne ende nuk kemi parë një reflektim nga ana e komunës me kontaktuar palën të cilës do t'i këmbehet prona private me pronën publike, në mënyrë që me vazhduar me projketin më tutje. Kjo vonesë e komunës e rrezikon seriozisht moszbatimin e këtij projekti; procedurat tenderuese vetëm se janë shpallur në projektin në fjalë, rrezikojmë t'i humbim 300,000,00 €.

Ne vazhdimisht jemi duke u përballur me problemin e ujit të pijes dhe rrezikojmë ta humbim një projket të madh së paku për ato fshatra që është parashikur të furnizohen. Ju lutem ta merni seriozisht, kontaktojeni palën ku do t'i këmbet prona e tij dhe pastaj kompania të fillojnë me punimet. Unë kam pranuar shumë mesazhe nga prindërit që janë duke u përballur me mungesën e transportit për fëmijët e tyre në shkollë. Në vitet e kaluara komuna ka pasur një kontratë me kombibus që i kanë bartur nxënësit që kanë jetuar në lagjet më të largëta dhe i kanë dërguar në shkollë. Në këtë vit fare nuk është zbatuar.

Sot e mora një mesazh nga një prind, i cili jeton në lagjen e "Muhaxherëve", i cili tha prej që ka filluar viti shkollor është detyruar me ia ndërpre mësimin, ai është në mardhënie pune, gruaja e tij nuk ka patentë shoferi nuk ka mundësi me dërgu vajzën e tij në shkollë në Tërpezë, pastaj edhe në fshatin Lladrovc është mbi 3 kilomenta rrugë e gjatë deri te shkolla sepse edhe moti është i ftoftë paraqet rrezik nga qenët endacak. E lus Drejtorinë e Arsimit ta marrë seriozisht këtë çështje, ta vazhdojë kontratën për transportin e nxënësve.

Çështja e tretë nëse ju kujtohet para dy seancave më herët, ne si Kuvend komunal e kemi marrë një vendim Draft Rregullore për caktimin e orarit të punës për subjekte afariste, kemi vendosur që orari i punës për marketet e mëdha të bëhet me rotacion, unë kam pranuar shumë ankesa nga punëtorë që kjo Rregullore nuk është duke u zbatuar fare. Atëherë po humbet rëndësia e çdo vendimi, ne jemi duke marrë vendime, kurse ato po mbesin vetëm në sirtarë dhe nuk po zbatohen. Ju lutem që të filloni me zbatimin e Rregullores, sepse ne si Kuvend kemi marrë vendim që qendrat e mëdhaja të marketit me punuar me rotacion ditën e diel, si dhe orari i punës për puntorë që puna shtesë duhet me jua paguar nga pronarët, të fillojë zbatimi i saj, drejtoria e Inspektoriatit duhet me u marrë në këtë rast.

Bashkim Krasniqi, (GP. NISMA): Faleminderit Kryesues! Të nderuar drejtorë, kolegë asambleistë si dhe ju të pranishëm. Sa i përket diskutimit jashtë rendit të ditës, unë do t'i ngris disa çështje, disa prej tyre u përsëritën nga parafolësi. E para ka qenë një afat që është marrë për rregullimin e Sallës së Asamblesë deri në muajin shtator, sot është data 29 shtator nuk ka asnjë lëvizje, nuk e di Kryesues për cilin shtator e keni diskutuar, por nëse është fjala për këtë shtator atëherë jemi vonë. Çështja tjetër është nëse nuk gaboj në mbledhjen e mbajtur më 22 maj, i kemi bërë disa bartje të të hyrave vetanake, njëra prej atyre që më intereson ta di është planifikimi mjedisor dhe inspektim, asfalltimi i rrugëve nëpër fshatrat: Ngucat, Kravasari, Llapqevë, Mirushë, Turiakë, Astrazub, Rud, Panorc, Pagarushë, Tërpezë e Poshtme, Shkarashnik, Lumishtë, Banjë, Gajrak, Carrallukë, Gurbardh, vlera ka qenë 50,000.00 €. Edhe atëherë e kam bërë një pyetje: A mund të realizohen këto rrugë me këtë shumë që keni kërkuar të bartën? Drejtor nuk kam marrë asnjëherë përgjigjje, kërkesa ka ardhur prej drejtorisë së tuaj. A janë realizuar këto projkete, a janë asfalltuar këto rrugë? Çështja e transportit të nxënësve, janë disa lagje të thella siç është ajo e "Muhaxherëve" në fshatin Tërpezë, sikur të ishim ne të njejtën pozitë me ata do të kishim vepruar njëjtë do t'i kishim ndalur fëmijët nga shkolla ose ishim ndalur nga puna njërën do të duhej bërë, nuk mundesh me leju fëmijën 5 ose 6 vjeçar apo edhe më i rritur të udhëtojë 4 kilometra për në shkollë, duke pasur parasysh rrezikun prej qenëve endacak. Kërkoj shpejt të bëhet një zgjidhje për transport siç

ka qenë në vitet e kaluara, për shkak se ka qenë një zgjidhje shumë e mirë që ata me shkuar të sigurtë në shkollë dhe me vazhduar procesin mësimor. Gjithashtu ka ardhur një kërkesë më shumë prej bizneseve që u përmend nga parafolësi z.Vetoni, Rregullorja për orarin e punës së bizneseve të merret seriozisht të përfundohet dhe të hyjë në fuqi, për shkak se është kërkesë e dy palëve: e punëtorëve dhe bizneseve që të rregullohet kjo çështje dhe dita e diel të jetë pushim përveç bizneseve që janë të domosdoshme të punojnë dhe atë me rotacion. Faleminderit!

Vlera Bytyçi (GP.LVV): Përshëndetje drejtorë, kolegë asambleistë, media dhe ju të pranishëm, qytetarët që na ndiqni. Sot i kam disa çështje para rendit të ditës, do të dëshiroja me qenë prezent në këtë takim edhe Kryetari i Komunës, mirëpo prapë vazhdojmë. Çështja e parë që dëshirojë me diskutuar këtu është çështja e Parkut të Mirushës, kisha dashur ta pyetur Kryetarin çfarë ka ndodhur me atë park? Ka qenë një investim i nënshkruar, një memorandum bashkëpunimi me Ministrinë e Zhvillimit Rajonal që nga viti 2023, është bërë një investim vlera e saj është 250,000.00 €, gjendja e parku dihet çfarë është, nuk e di se si është bërë pranimi teknik në atë park mbi të gjitha. Ai park po shpallet zonë me interes, dhe kujt po iu duhet me dhënë në shfrytëzim? Çështje e dytë është për drejtorin e urbanizmit. I nderuar drejtor, në seancën e kaluar kemi bërë një pyetje për energjinë elektrike për Lagjen e Re përkatësisht në rrugën "Hilë Mosit".

Ju jeni deklaruar se keni dërguar kërkesa në KEDS, unë kam paraqitur kërkesë zyrtare, por përgjigjje nuk kam marrë, tani po ju bëjë pytje përsëri. Cila është kërkesa që ju e keni bërë në KEDS, dhe cila është përgjigja e tyre në lidhje me këtë rrugë, sepse banorët e kësaj lagjeje kanë bërë kërkesë vazhdimisht te komuna. Çështje tjetër është e mbeturinave, kompania ka qenë e autorizuar për bartjen e dheut nga qendra deri afër stadiumit, por ata nuk kanë bartur vetëm dheun, por edhe mbeturina të tjera, nuk e di drejtoria e Inspektoriatit a kanë dalë me parë atë gjendj, sepse unë vazhdimisht marrë foto dhe video nga trajnerët e shkollës. Një pyetje tjetër shkonë për drejtorin e Bujqësisë, unë nuk e di si ka qenë vendimi nga Kuvendi, pasi ky vendim është marrë në kohën kur unë nuk kam qenë asambleiste, subvencionimi për litrën e qumështit, disa bujq kanë shprehur ankesat e tyre sepse ky subvencionimi nuk iu është bërë. Dëshiroj me pyetur si është gjendja e tyre me subvencione? Çështja e fundit që dëshiroj ta ngrs është e ujërave e zeza afër shkollës "Imer Krasniqi", nga banorët aty që jetojnë kam marrë informacione që tani edhe banjot e shkollës janë të pashfrytëzuara. Si është gjendja në këtë shkollë? Drejtoria e Arsimit a ka marrë ndonjë masë për këtë gjendje? Faleminderit!

Mërgime Robaj (GP.PDK): Faleminderit Kryesues! Përshëndetje për të gjithë! Unë e kam një shqetësim për shkollën e Vërmicës, që dyert e klasave janë të dëmtuara, të cilat kanë nevojë për riparim ose zëvendësim; gjithashtu një shqetësim tjetër është – gjendja e klasës së parë ku në atë klasë me të cilën vijojnë mësimin nxënësit ka prani të mykut dhe rrjedhje të ujit, janë kushtet e vështira të cilat e rrezikojnë drejtpërdrejt shëndetin dhe sigurinë e fëmijëve të ciët qëndrojnë çdo ditë aty. Kërkoj nga ju që këto çështje të trajtohen me prioritet nga ju dhe të merren masat e nevojshme për përmirësimin e kushteve në shkollë. Unë i kam edhe fotografi të cilat e dëshmojnë gjendjen, të cilat mund t'i prezantojë para juve që ta keni më qartë si është gjendja e dyerve dhe dhe gjendja e mykut në shkollën e Vërmicës. Kjo nuk është vetëm kërkesë e imja, por edhe e stafit mësimor edhe e prindërve.

Demir Bajra (GP-PDK): Përshëndetje për të gjithë! Sikur të më dëgjojnë kolegët e partive të tjera, unë sot nuk do të qëndrojë në sallë, sepse janë ndarë mjetet dhe ju jeni zotuar që në shtatorin e ardhshëm që bëhet fjalë tani për këtë shtator që do të rregullohet salla, dhe më vjen keq që Nisma socialdemokrate me qenë në këtë gjendje, për mua është e pakuptimtë. Unë i kam disa kërkesa edhe për emërtimin e rrugëve nuk e di a ka komision apo duhet me u formuar komision dikush nga ekzekutivi me na dhënë një shpjegim. A është funksional komisioni për emërtimin e rrugëve? Në fshatin Panorc janë duke hedhur mbeturina inerte, rrezikon me u mbyllur ajo rrugë, unë kam biseduar me drejtorin, mirëpo nuk ka fare interesim për këtë çështje. Çështja e transportit të nxënësve është e njëjtë edhe në fshatin Panorc, sepse nuk kanë transport, në krahasim me vitet e kaluara që kanë bërë bartjen e nxënësve.

Enver Hoti (GP. AAK): Faleminderit Kryesues!Të nderuar anëtarë të Asamblesë, i nderuar kabinet qeveritar, të nderuar qytetarë! Unë do t'i ngris disa shqetësime.Të gjithë jemi dëshmitarë me realizimin e projektit për rregullimin e rrugëve, që ka sjellë shumë pasoja te qytetarët, punimet janë duke shkuar shumë ngadalë, kërkoj nga qeveria komunale të jetë më aktivë të bashkëpunoj me kompaninë ose t'i përdor mekanizmat institucional për realizimin sa më shpejtë. I nderuar kabinet qeveritar, jemi duke u afruar në sezonën e vjeshtës dhe dimrit, ju e dini si jemi ballafaquar me vërshime. Unë e kam një pyetje: para disa muajve kemi pasur disa qëndrime lidhur me gjendjen e vërshimeve, pasoajt të cilat i kanë sjellë ato për qytetarë dhe institucione. A keni ndërmarrë diçka që ky dimër dhe pranvera e ardhshme mos me na gjetur si herën e kaluar? Cilat do të jenë pasojat nëse nuk e keni realizuar asnjë masë, ose intervenim si fazë e parapregaditur? Tema tjetër e cila është e rëndësishme, shkollat. A jeni përgatitur sepse kemi probleme të mëdhaja duke filluar nga nxemja, mjetet higjenike, sepse këto ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë e mësimit. Unë me sa jam duke e vërejtur është duke u përsëritur gjendja e njëjtë çdo vit. Një pikë tjetër e cila është e rëndësishme për të cilën do të ishte mirë me qenë edhe Kryetari prezent. A do të vazhdojë komuna me penalizime buxhetore për shkak të Kontratës Kolektive, ose për shkak të papërgjegjësive të tjera të cilën e keni parë në raportin e auditimit? Janë bërë dëme të mëdha në buxhetin e komunës tonë. Unë nuk e di a do të mbahen zgjedhjet nëpër fshatra, por nëse i mbajmë, do të ishte mirë me kthyer secili fshat ta ketë udhëheqjen e vetë e jo në udhëheqjen e Bashkësive lokale, siç ka qenë në këtë mandat, jam duke ju paralajmëruar sepse ka pasur ankesa të shumta. Faleminderit!

Halil Morina (GP. NISMA): Përshëndetje kolegë asambleistë, të nderuar drejtoë, media, qytetarë të komunës së Malishevës! Unë do ta ngris një shqetësim për mosfunksionalizimin e dy çerdheve në komunën e Malishevës për shkak të mungesës së stafit. Objektet e çerdheve janë financuar nga qeveria e Republikës së Kosovës për të cilën unë shpreh falenderim ndaj tyre, mirëpo për t'u funksionalizaur këto çerdhe, duhet pasur edhe stafin punues, ne e kemi para vetes buxhetin për vitin 2027-të, mirëpo nuk e kemi të përfshirë stafin e duhur për funksionalizimin e tri çerdheve. Unë i bëj apel Ministrisë së Arsimit dhe secilit akter që ka të bëjë me këtë çështje, të na mundësojë stafin e duhur të punëtorëve në mënyrë që ato çerdhe të funksionalizohen e fëmijët e komunës së

Malishevës ta vijojnë edukimin e hershëm. Në komunën e Malishevës ka shumë rrugë të cilat janë dëmtuar: kanalizime të dëmtuara, ka nëpër shkolla klasa të dëmtuara, mirëpo unë po përsëris edhe një herë, nëse ne dëshirojmë me qenë të sinqertë dhe me paraqitur para qytetarëve të komunës së Malishevës tablon e plotë, në krahasim me nevojat e tyre, duhet me ua bërë të qartë edhe mundësitë që i ka komuna e Malishevës. Në mandatin e kaluar, po edhe në këtë manda, komuna e Malishevës ka realizuar shpenzimet 100% për investime kapitale, që do me thënë i ka shtjerrur të gjitha mundësitë e veta financiare në shërbim të nevojave të qytetarëve. Kërkesat dhe nevojat e qytetarëve janë shumë më të mëdha sesa mundësitë tona financiare, duhet me pasë parasysh edhe problemet që i kemi me përmbarues, edhe kjo e bënë të pamundur që ne si komunë në tërësi legjislativ dhe ekzekutiv t'i plotësojmë të gjitha nevojat e qytetarëve të Malishevës. Partia e Nismas është që katër mandate në qeverisje dhe jo rasishtëisht është që katër mandate,sepse para se me i bërë kariget e lëkurës, këtu në sallën e kuvendit, ajo është kujdesur fillimisht për nevojat e qytetarëve të Malishevës, kështu do të vazhdojë edhe në mandatin e pestë dhe gjashtë, e kështu me rradhë.

Fatmir Ademaj (Kryesues i Kuvendit): Ne në buxhet e kemi votuar, kërkesën për rregullimin e Sallës së Kuvendit, unë nga drejtori i urbanizmit e mora përgjigjen se vendimi është marrë dhe pritet të fillojë me proceduarat.

Avdi Morina (Drejtor për Urbanizëm): Përshëndetje për të gjithë! Unë do t'u përgjigjem disa pyetjeve që i parashtruat. I nderuar *z.Bashkim* disa rrugë janë rregulluar, kurse disa të tjera kanë mbetur për shkak të mungesës financiare për arsyeje se i ka marrë përmbaruesi. E nderuar *znj.Vlera* ju falenderojë për interesim, ju jeni drejtuar edhe me kërkesë zyrtare, unë personalisht kam qenë mbi dhjetë herë në zyret e KEDS-it për këtë çështje, mirëpo këto kërkesa ju lutemi paraqiteni në KED, jo tek ne sepse ne nuk jemi përgjegjës për me vendosur trafo me rrjetin elektrik. Ne kemi problem me furnizim të energjisë elektrike edhe në disa fshatra të tjera për shkak të tensionit ZRE, sepse janë shtyllat e dobëta. Kërkesa nuk është vetëm për lagjen "Hilë Mos" por edhe për katrëmbëdhjetë fshatra të tjera. Ne kemi pasur takim dhe ata na kanë thënë që ZRE-ja nuk po ju lejon me investu, mirëpo kjo nuk është arsyeje ata e kanë një kontratë dhe duhet të bëjnë investime. Një pyetje tjetër ishte edhe emërtimi i rrugëve, tani duhet me u formuar Komisioni i ri sepse ka kaluar afati ligjor kur ne kemi mundësi m'i bërë disa plotësime dhe ndryshime të emërtimit të rrugëve. Ne do ta formojmë komisionin e ri për emërtimin e rrugëve të reja.

Sylë Dukolli (Drejtor për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural): Përshëndetje për të gjithë! Unë do t'i përgjigjen pyetjes që e parashtroi anëtarja nga rradhët e partisë LVV, ne jemi në muajin tetor që e hapim muajin për aplikim edhe pse kemi mbetur gjashtë muaj mbrapa për shkak të mjeteve edhe për shak të angazhimeve të pandalshme që i kemi pasur, në muajin korrik Qeveria e ka hapur aplikimin për subvensione. Mua më vjen mirë që biesdoni me fermerë, unë dëshiroj me ju bërë një pyetje pasi që bisedoni me ata, i pyesni. A ju kanë kompenzuar dëmet nëpër ara që tri vite? Çfarë ka ndodhur nga 45 cent në 28 cent ka ra litra e qumështit, sa kanë humbur aty?

Që sa vite nuk i keni marrë mjetet e subvencionimit në drejtim të ministrisë që jeni duke aplikuar? Që nga viti i kaluar ende nuk është bërë ribursimi i mjetet që kanë aplikuar. Ne në komunë i kemi mjetet e buxhetit të kufizuara.

Vlera Bytyçi (GP. LVV): Drejtor ju faleminderit për përgjigjen. Pyetja ime nuk ishte tendencioze ndaj juve. I nderuar drejtor i Urbanizmit, kërkesën që e kam drejtuar te ju ka qenë në lidhje që me ndihmuar në këtë çështje, lagjja e "Hilë Mosit " gjindet në qytet, nuk është në fshat. Unë e di që në fshatra ka rrjet të dobët elektrik, po për kërkesën e energjisë elektrike në lagjen e "Hilë Mosit" kësaj pyetjeje duhet m'i dhënë një përgjigje.

Avdi Morina (Drejtor për Urbanizëm): E nderuar ju keni shumë të drejtë dhe pajtohem plotësisht me shqetësimin tuaj. Unë ju tregova që kam qenë me dhjetra herë dhe ajo është kompetencë ekskluzive e KEDS-it për zgjerimin e rrejtit të energjisë elektrike, edhe ne po deshëm të investojmë nuk kemi të drejtë. Unë ju tregova që kemi problem me energji elektrike edhe për katrëmbëdhjetë fshatra të tjera.

Demir Bajra (GP. PDK): Në ulset që jemi ulur ne në këtë sallë janë shumë të dëmtuara, ju lutem ejani uluni te vendi im për gjashtë ose shtatë orë, ta shihni gjendjen në të cilën jemi. Por kjo sallë duhet me i përmbushur kushtet që i plotëson për me pasur mundësi të qëndrojë secili që vjen këtu.

Enver Hoti (GP. AAK): Kryesues ju lutem me ju përmbajtur rregullave të Kuvendit, mos të bëjmë deklarime jashtë rendit të ditës duke promovuar sa më shumë përqeshje elektorale. Drejtorët nëse kanë mundësi të na përgjigjen këtë seancë mirë, nëse jo le të mbajnë shënime dhe të përgjigjen herën e ardhshme.

Izet Hoti (Drejtor për Shërbime Publike): Përshëndetje për të gjithë! Unë do t'u përgjigjem pyetjeve që i parashtruan disa asambleistë. Unë kam pasur një takim me komisionin e kompanisë së Hidroregjionit dhe kemi ngritur shqetësimet tona.Te çështja e kanalizmit dhe bllokimit të tyre është kompetente kompania e Hidroregjionit, e cila e ka një kontratë dhe monitorohet nga ata dhe merret me punimet për bllokimin e kanalizimeve. Në këtë vit ka ndodhur një bllokim i madh i kanalizimit dhe janë krijuar probleme të mëdha, pastaj janë paraqitur kërkesa nga qytetarët, por unë mendoj që Hidroregjioni duhet me qenë më fleksibël, duhet me kryer punën të cilën e kanë me kontratë. Ne së bashku me Kryetarin e kemi hartuar një projekt i cili do të merret me riparimin e gypave të kanlizimit si dhe rregullimin e tyre në tërësi, të cilat do të kryhen brenda afatit të caktuar. Për deponitë ilegale ne e kemi marrë një aksion edhe për këtë punë kemi marrë lavdata dhe prapa do të vazhdojmë me projekte të tilla. Unë kërkoj një vetëdije më të lartë të qytetarëve sa i përket mbrojtjes së ambientit. Ju faleminderit!

Jakup Gashi (Drejtor i Inspektoriatit): Përshëndetje për të gjithë! Sa i përket pyetjes të cilën e parashtroi *z.Zogaj* në lidhje me Rregulloren e subjekteve afariste më datën 11 shtator kemi marrë një shkresë nga ana e ministrisë për ndryshimin dhe harmonizimin e nenit 21 dhe nenit 23, komisioni ka bërë harmonizimin e këtyre neneve të cilat priten me ardhë në seancën e ardhshme për ndryshim. Pas ndryshimit të atyre neneve të cilat në njërën pikë gjobat janë të përcaktuara më të mëdha dhe duhet me u harmonizuar me ligjin për kundërvajtje; ndërsa te neni tjetër që për zbatimin e kësaj Rregullore duhet të kujdeset inspektoriati dhe policia, ndërsa ministria e linjës ka kërkuar që të tërhiqet policia dhe të mbetet vetëm inspektoriati.

Veton Zogaj (GP. LVV): Unë shkurt do të ndërlidhem me debatin që e pata me drejtorin e Bujqësisë. Kolegia ime *znj.Vlera* është e përgatitur në atë masë për me thënë atë që mendon. I nderuar drejtor *z.Syla* për secilin raport dhe për secilën kërkesë që ju e keni sjellë në Kuvend ne ju kemi besuar dhe ju kemi mbështetur gjithmonë me votën ***Për*** ndaj juve. Pyetja e *znj.Vlera* nuk ishte aspak tendencioze, por ishte e sinqertë dhe me dashamirësi për kërkesën e bujqve. Përgjigja e juaj drejtor ishte skandaloze. Ne jemi asambleistë të Kuvendit Komunal, sigurisht që ne i trajtojmë çështjet e Kuvendit Komunal, por për çështjet e nivelit qendror ne mund t'i ngrisim dhe dhe të ndajmë shqetësimin, por ne nuk jemi kompetentë dhe as ju nuk jeni kompetentë për me dhënë përgjigjepër ato.

Blerim Thaçi (Drejtor për Ekonomi dhe Financa): Unë do të përgjigjem për pyetjen që e parashtroi *znj.Mergime.* Kontrata është në fuqi dhe kam marrë informacione, që një komisioni ka shkuar dhe kanë marë disa paramasa dhe besoj që shumë shpejt do të renovohet shkolla në fshatin e Vërmicës.

Fatmir Ademaj (Kryesues i Kuvendit): Ju faleminderit!
Kalojmë te pjesa e rendit të ditës, të cilën ju e keni pranuar me kohë. A ka dikush për me marrë fjalën për rendin e ditës?

Halil Morina (GP. NISMA): Sa i përket rendit të ditës, unë i kam dy çështje: njëra ka të bëjë me një pikë të re të rendit të ditës dhe, tjetra ka të bëjë me ndryshimin e renditjes sa i përket një pikës së rendit të ditës. Sa i përket propozimit të ri të pikës së rendit të ditës, në cilësinë e shefit të grupit të Nismas, propozoj që në këtë mbledhje të Kuvendit të Komunës së Malishevës të përfshihet pika: *Shqyrtim dhe miratim i deklaratës për aktgjykimin e Dhomave të Specializuara të Kosovës në Hagë.* Secili prej neve jemi të shqetësuar ndaj atij aktgjykimi dhe shprehim indinjatën e thellë, ndaj atij vendimi të padrejtë. Me këtë propozim të kësaj pike nuk shprehet vetëm një qëndrim i një partie politike, por me anë të kësaj deklarate shprehet një reflektim përfundimtar dhe i përbashkët për të gjithë anëtarët e Kuvendit. Ne së bashku me shefat e grupeve politike e kemi harmonizuar një deklaratë të cilën ju e keni para vetes. Kërkojë që kjo pikë të futet si pikë e parë e rendit të ditës dhe të votohet. Sa i përket çështjes së dytë me kërkesën e drejtorit të Urbanizmit kërkojë që pika e gjashtë e rendit të ditës të vendoset si pikë e dytë e rendit të ditës.

Fatmir Ademaj (Kryesues i Kuvendit): Ne së bashku me shefat e grupeve politike e kemi harmonizuar tekstin për deklaratën dhe padyshim se do ta vendosin në rendin e ditës dhe do ta votojmë deklaratën. Vlerat e ushtrisë çlirimtare të Kosovës nuk ka një grup parlamentar që i mbron, por i mbronë i gjithë populli i Republikës së Kosovës. Unë ju bëj thirrje për unitet dhe qetësi ashtu siç e parasheh edhe kjo deklaratë. Atëherë i vendosim në votimet propozimet e z.Halilit. Kush është **për**? Anëtarët e Kuvendit votuan unamisht që pikë e rendit të ditës të jetë: *Shqyrtim dhe miratim i deklaratës për aktgjykimin e Dhomave të Specializuara të Kosovës në Hagë* si dhe të ndryshohet renditja e pikës së gjashtë të kalonë si pikë e dytë e rendit të ditës.
Rezultati i votimit: 25 **për, kundër** 0, **abstenim** 0.

Kryesuesi i Kuvendit e vuri në votim me plotësim dhe ndryshim rendin e ditës si në vijim:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i Deklaratës së Kuvendit Komunal të Malishevës.
2. Shqyrtimi dhe miratim i procesverbalit të mbledhjes së pestë të rregullt nga mbledhja e kaluar e mbajtur, më datë:22.07.2026.
3. Shqyrtimi i kërkesës së drejtorisë për Urbanizëm, nr.05/266, dt.01.06.2026, për marrjen e pëlqimit për harmonizimin e vendimit sipas Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës dhe vënien nën mbrojtje të Monumentit të Natyrës –"Rrjedha e lumit Mirusha" konform propozimit profesional të Grupit punues.
4. Shqyrtimi i parashtresës së kryetarit të komunës nr.01/1599, dt.15.09.2026, në lidhje me kërkesën e drejtorisë për Urbanizëm për inicimin e hartimit të Planit Zhvillimor Komunal 2027-2035 dhe Hartës Zonale të Komunës së Malishevës.
5. Shqyrtimi dhe miratimi i draft Buxhetit për Komunën e Malishevës 2027/2029, me theks të veçantë për vitin 2027, nr.04/481, dt.31.08.2026.
6. Shqyrtimi i Raportit të Auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Malishevës për vitin 2025, i Zyrës Kombëtare të Auditimit.
7. Shqyrtimi i Raportit të përformancës së Komunës së Malishevës për vitin 2025.
8. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit të Kryetarit të Komunës së Malishevës, për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës së Malishevës në shfrytëzim afatshkurtër përmes ankandit publik, deri në 15 (pesëmbëdhjetë) vjet, për organizatat e shoqërisë civile me qëllim të organizimit dhe funksionalizimin e qëndrimit ditor për të moshuar, kuzhinës humanitare dhe Qendrës për fëmijë me nevoja të veçanta shëndetësore.
9. Formimin e komisionit vlerësues me rastin e dhënies në shfrytëzim të pronës publike përmes ankandit publik deri 15 (pesëmbëdhjetë) vjet.
10. Shfuqizimi i Vendimit nr.02/230, dt.29.07.2026, konform shkresës nr.02/4438-2/26, dt.31.08.2026, të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në lidhje me miratimin e kërkesës nr.01/12/15, dt.08.01.2026, të parashtruar nga KRM "Ekoregjioni " sh.a në Prizren.

11. Rishqyrtimi i vendimit të Kuvendit të Komunës së Malishevës, nr.02/224, dt.22.07.2026, në lidhje me inicimin e procedurave administrative për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës publike deri në 15 vjet përmes procedurës së ankandit publik.
12. Rishqyrtimi i vendimit të Kuvendit të Komunës së Malishevës, nr.02/226,dt.22.07.2026, për formimin e Komisionit Vlerësues për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës publike deri në 15 vjet përmes procedurës së ankandit publik.
13. Rishqyrtimi i vendimit të Kuvendit të Komunës së Malishevës, nr.02/225, dt.22.07.2026, Vendimi përfundimtar për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës së Malishevës përmes procedurave të shprehjes së interesit publik.
14. Rishqyrtimi i vendimit të Kuvendit të Komunës së Malishevës, nr.02/221, dt.22.07.2026, Vendimi përfundimtar për dhënien në shfrytëzim afatgjatë deri 30 (tridhjetë) vjet, të pronës së paluajtshme të komunës së Malishevës për subjektin afarist "Pashtriku" me menaxher drejtues z.Afrim Gigollaj.
15. Shqyrtimi i raportit të komisionit të formuar sipas Vendimit, nr.01/1590, dt.11.09.2026.
16. Shqyrtimi i kërkesës nr.02/201, dt.10.07.2026, e parashtruar nga z.Ardian Aziz Telaku nga fshati Banjë, Komuna e Malishevës, për këmbimin e pronës private me pronë publike.
17. Të ndryshme.

Rendi i ditës u miratua unanimisht nga anëtarët e Asamblesë Komunale.
Rezultati i votimit: 23 ***për***, ***kundër*** 0, ***abstenim*** 0.

1) Shqyrtimi dhe miratimi i Deklaratës së Kuvendit Komunal të Malishevës.

Fatmir Ademaj (Kryesues i Kuvendit): Unë do ta lexoj deklaratën e cila është unifikuar nga të gjitha subjektet e partive politike në Malishevë.

KUVENDI I KOMUNËS SË MALISHEVËS

Për aktgjykimin e Dhomave të Specializuara të Kosovës në Hagë

D E K L A R A T Ë

- Kuvendi i Komunës së Malishevës në emër të qytetarëve të komunës së Malishevës, shpreh mospajtimin e tij të thellë ndaj aktgjykimit të shkallës së parë të Dhomave të Specializuara të Kosovës ndaj ish-drejtueseve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës:
  z. Hashim Thaçit, z. Kadri Veselit, z. Rexhep Selimit dhe z. Jakup Krasniqit.

- Kuvendi i Komunës së Malishevës, e vlerëson se lufta e Ushtrisë Çlirimtare e Kosovës ishte luftë e drejtë, çlirimtare dhe e pastër për lirinë dhe çlirimin e Kosovës nga represioni, dhuna dhe dëbimi i popullit shqiptar nga regjimi serb. Qytetarët e komunës së Malishevës kanë përjetuar drejtëpërdrejt luftën dhe sakrificën për liri.

- UÇK-ja mbetet simobolë i rezistencës dhe i luftës për çlirimin e Kosovës. Asnjë aktgjykim nuk mundet me ndryshuar këtë bindje dhe këtë vlerësim historik të qytetarëve të komunës së Malishevës.

- Kuvendi Komunal i Malishevës respekton institucionet e drejtësisë dhe të drejtën e palës për të përdorur të gjitha mjetet juridike, por nuk pajtohet me aktgjykimin e Dhomave të Specializuara dhe nuk e pranon atë si pasqyrim të Luftës së drejtë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

- Në këtë frymë, Kuvendi Komunal i Malishevës shpreh:

1. Shpreh mosjpajtimin e thellë ndaj aktgjykimit të Dhomave të Specializuara;

2. Konsideronë të papranueshme përfundimin, mbi ekzistencën e një qëllimi të përbashkët criminal;

3. Kërkonë ndaj institucioneve shtetërore të Republikës së Kosovës, të ndërmarin të gjitha veprimet e nevojshme për mbojtjen dhe afirmin e së vërtetës historike për Luftën e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës;

4. Rikonfirmonë qëndrimin se Lufta e UÇK-së ishte luftë e drejtë dhe çlirimtare për lirinë e Kosovës;

5. Thekson se aktgjykimi nuk përfaqëson qëndrimin e qytetarëve të Malishevës ndaj luftës së UÇK-së dhe sakrificës së saj;

6. Shpreh bindjen se përfaqësuesit politikë dhe ushtarakë të UÇK-së nuk mund të identifikohen me një narrativë që njollos karakterin çlirimtar të luftës së Kosovës;

7. Bën thirrje për unitet, qetësi, dinjitet dhe përgjegjësi institucional. *Faleminderit!*

Halil Morina (GP. NISMA): Ne si anëtarë të grupit politikë të Nismas, e mbështesim në tërësi këtë deklaratë të përbashkët të Kuvendit Komunal të Malishevës. Për neve Ushtria Çlirimtare e Kosovës është e pastër si loti, lufta e saj ka qenë çlirimtare. UÇK-ja ka qenë një organizatë e përbashkët, politike ushtarake dhe qëllimin e vetëm ka pasur çlirimin dhe pavarësimin e Kosovës. Ne si grup jemi **pro** dhe e votojmë me kënaqësinë më të madhe.

Burim Paçarizi (GP. PDK): Përshëndetje për të gjithë! Ne si grup i Partisë Demokratike të Kosovës, padyshim që këtë deklaratë e mbështesim fuqishëm dhe konsiderojmë se të gjitha pikat që i lexuat jemi në mbështetje të atyre njerëzve që e kanë bërë luftën dhe kanë dhënë kontributin më të madh që ne sot të jemi të lirë dhe të punojmë të panvarur në shtetin e Republikës së Kosovës. Ne e vlerësojmë se aktgjykimi i Dhomave të Specializuara ndaj ish-krerëve të luftës është urdhër politikë dhe asesi në fake të cilat i kemi parë gjatë procesit të gjykimit. Ne jemi që aktgjykimi i cili ka ndodhur në Dhomat e Specializuara nuk është në emrin tonë dhe në emrin e qytetarëve të Republikës së Kosovës. Ne e mbështesim fuqishëm këtë deklaratë me votën tonë.

Fitim Shala (GP. LDK): Në emër të Lidhjes Demokratike të Kosovës i jepim mbështetje të plotë deklaratës së përbashkët të Kuvendit Komunal të Malishevës ndaj udhëheqësve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, njëkohësisht e shprehim edhe indinjatën tonë ndaj aktgjykimit të cilën e kemi shprehur me shkrim në këtë deklaratë.

Veton Zogaj (GP. LVV): Në emrër të grupit paralamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, jo vetëm që e mbështesim, por jemi edhe **pro** për secilën nisëm, e cila ka të bëjë me Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës. Sepse besojmë dhe jemi të bindur që UÇK-ja është projekti më i madh i kombit shqiptar në historinë e fundit. Ne jemi për me ju mbështetur në çfarëdo forme që kërkohet për vlerat e UÇK.

Enver Hoti (GP. AAK): Në emër të Aleancës e mbështeti deklaratën. Lufta jonë nuk mundet me u paraqitur si luftë civile e qytetarëve. Ajo ishte luftë për çlirim dhe pavarësi. Shpresojë që e drejta së shpejti do të triumfojë.

Kryesuesi i Kuvendit, konstatoi se u miratua unanimisht: *Shqyrtimi dhe miratimi i Deklaratës së Kuvendit Komunal të Malishevës.*
Rezultati i votimit: 25 **për, kundër** 0, **abstenim** 0.

Fatmir Ademaj (Kryesues i Kuvendit): Ju falëminderit! Uroj që Gjykata e Apelit t'i marrë në konsideratë të gjitha veprimet e luftës në Kosovë dhe ta korrgjojë vendimin e shkallës së parë.

2) *Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së pestë të rregullt nga mbledhja e kaluar mbajtur me datë, 22.07.2026.*

Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se *Procesverbali nga mbledhja e pestë e rregullt* e mbajtur me datë:22.07.2026 u miratua unanmisht nga anëtarët e Asamblesë Komunale.
Rezultati i votimit: 23 **për, kundër** 0, **abstenim** 0.

3) *Shqyrtimi i kërkesës së Drejtorisë për Urbanizëm, nr.05/266, dt.01.06.2026, për marrjen e Pëlqimit për harmonizimin e vendimit sipas Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës dhe vënien nën mbrojtje të Monumentit të Natyrës "Rrjedha e lumit Mirusha" konform propozimit profesional të Grupit punues.*

Avdi Morina (Drejtor i Urbanizmit): Ne e kemi ftuar përfaqësuesin e komisionit *z.Sami Behrami*, i cili do të na japë shpjegime sa i përket kësaj shkrese dhe lënde.

Sami Behrami (*Udhëheqës i sektorit të zonave për mbojtjen e natyrës*): Përshëndetje për të gjithë! Kam nderin dhe kënaqësinë që jam sot para juve dhe do të flas për arsyeshmërinë që e ka punuar Grupi punues për lumin Mirusha. Në bashkëpunim me drejtorinë për urbanizëm, instituti ka themluar një grup punues në këtë grup kanë qenë edhe tre profesorë të Fakultetit të Shkencave të Natyrës, respektivisht të departamentit të biologjisë, të cilët kanë bërë hulumtim në zonën dhe kanë marrë përfundim për vënien nën mbrojtje të monumentit të natyrës rrjedha e lumit Mirusha. Për informacionin tuaj lumi Mirusha statusin e zonës së mbrojtjes e ka që nga vitit 1983, mirëpo për shkak të ligjit për mbrojtjen e natyrës, e cila nga statuti i mbrojtur më herët nuk korrespondon me ligjin e natyrës, ka qenë qëndrimi me harmonizimin e ligjit dhe konstatimin e vlerave për të cilat ka qenë i mbrojtur edhe më heret. Ato vlera janë konstatuar dhe janë përfshirë në raportin e arsyeshmërisë i cili ka qenë edhe në diskutim publik për tridhjetë ditë me të cilën ju keni pasur afatin e caktuar për me i paraqitur vërejtjet, sygjerimin, plotësimin apo ndryshimin e juaj. Me hulumtimet e reja që janë bërë është konstatuar që zona e cila duhet të mbrohet është zona e rrjedhës së lumit Mirusha nga penda e Mirushës në hyrje të saj, e deri në zonën e lumit Mirusha respektivisht te ujëvarat e Mirushës. Pra gjatësia për vendin e mbrojtjes është zvogëluar për shkak të ndikimeve që ka pasur në rrjedhën e saj të epërme. Në këtë zonë është konstatuar prezencë e lartë e botës bimore dhe shtazore e ujërave përgjatë rrjedhës së saj që ka qenë edhe një element kryesor që na ka shtyer që këtë pjesë me marrë në mbrojtje. Në këtë dokument i kemi bashkangjitur edhe dy brigjet e lumit me lartësi 15 metra, i cili do të jetë në mbrojtje. Zona e cila është shpallur është kategori monument i natyrës i cili mbetet në kompetencë të komunës për menaxhim dhe administrim që do me thënë është përgjegjëse komuna. Në rast të intervenimit në këtë pjesë kërkohen planet detaje dhe një pëlqim prej anës së Ministrisë përkatëse. Unë jam në dispozicionin tuaj nëse keni pyetje të parashtroni. Unë nuk e di a kam të drejtë, por ju ftoj që ta miratoni sepse është një vlerë natyrore që duhet të mbrohet, në rradhë të parë për Komunën e Malishevës edhe tani për Kosovën në përgjithësi.

Fatmir Ademaj (Kryesues i Kuvendit): Ju falëminderit për elaborimin e kërkesës tuaj. E hapi debatin për këtë pikë të rendit të ditës.

Veton Zogaj (GP. LVV): Unë do ta mbështeti ***pro*** kërkesën e Drejtorisë së Urbanizmit, por e kam vetëm një pyetje për zyrtarin: - Pse është përjashtuar kjo pjesa prej pishinës së Banjës deri te liqeni i Mirushës? Mbi cilën bazë, kur ne e dimë që burimi kryesore i lumit është te pishina e Banjës? - A keni parashikuar diçka tjetër, pse është larguar prej zonës së mbrojtur?

Burim Paçarizi (GP. PDK): Faleminderit për prezantimin edhe ne do ta mbështesim kërkesën. Ju i përmendët disa detaje me rëndësi për lumin Mirusha. Unë i bashkangjitem pyetjes së z.Vetonit. - Pse është zvogëluar gjatësia për ta futur në mbrojtje nga penda deri te burimi kryesor i Banjës apo deri tek Bllaca? Ndërsa për pjesën tjetër uroj që në momentin që votohet ky dokument të respektohet në tërësi dhe në vazhdimësi rrjedha e lumit Mirusha. Ne në Kosovë e dimë që vazhdimisht kemi probleme me lumenj dhe mirëmbajtjen e higjienës së tyre.

Bashkim Krasniqi (GP. NISMA): Faleminderit Kryesues! Unë dëshirojë një pyetje të shkurtër ta bëj në lidhje me atë që e tha zyrtari i Ministrisë që do të fillojë me mbrojtje dhe do ta ketë një perimetër prej 15 metra në të dy anët. A mund t'na tregoni më detajisht se çfarë përfshin kjo pejsa e zonës prej 15 metra. A do të bëhet Udhëzim Administrativ i veçantë që parasheh trajtimin e kësaj zonës? A lejohet ndërtim apo cilat janë veprimet që duhet m'i ndërmarë komuna për shembull për me mbrojtur këtë pjesë që mos me lejuar do me thënë të degradohet ose të ndërtohet; me marrë forma jo të rregullta, edhe nëse ka mundësi ose nuk është udhëzimi ose nuk janë të paraparë kushtet. Atëherë a na tregoni çfarë do të bëhet me këtë pjesën tjetër të veçantë për këtë çështje?

Fitim Shala (GP. LDK): Në parim kjo kërkesë do ta ketë mbështetjen e grupit tonë. Duke e pasur parasysh që kemi të bëjmë me bukurinë natyrore dhe mbrojtjen e ekosistemit siç e theksoi edhe zyrtari. Unë ju bashkangjitem edhe pyetjeve të parafolësve të mi. Cila është ajo arsyeja që është anashkaluar ajo pjesë dhe mos të hyjë në mbrojtje? Në zonën e mbrojtjes prej 15 metra çfarë lejohet dhe çfarë nuk lejohet në atë zonë? Cilat janë ato kriteret nëse një person i ka 20 ari tokë dhe dëshironë me ndërtuar aty një shtëpi ose diçka tjetër?

Enver Hoti (GP. AAK): E falënderoj zyrtarin për prezantimin, e kam vetëm një pyetje: çfarë do të ndodh me liqenin, nëse liqeni nuk është në mbrojtje? Mendoj që është vetëm një e treta në mbrojtje nëse mund ta kufizoj kështu. Në vitin 1983 ju e pohuat se e keni pasur një Rregullore ose një ligj që ka qenë në mbrojtje lumi Mirusha. A do ta ketë fatin e shumë lumenjve në Kosovë që sot nuk ekzistojnë se janë përzier me kanalizime dhe iu kanë hyrë ujërat e zeza? Unë nuk do ta votojë dhe jam kundër dhe arsyejet janë shumë të qarta, sepse mendoj që i nderuar zyrtar dhe ju qeverisje komunale që edhe njëherë ta rishqyrtoni vendimin, sepse është në interesin e krejt kësaj zone, interesin e komunës dhe interesin e ekosistemit në tërësi dhe unë mendoj që mbi të gjitha është në interes me marrë masa parandaluese që nesër apo pasnesër ne me këtë vendim mos të bëhemi shkak që ndoshta 70% e ujit të pijes mos të ekzistojë fare. Unë jam i shqetësuar se çfarë do të ndodh me lumin Mirusha? Unë do të votojë kundër.

Hafir Rrexha (GP. NISMA): Përshëndetje për të gjithë! Në të dyja anët e lumit nga 15 metra do të jetë zonë e mbrojtur dhe ne si banorë të asaj zone që jetojmë në të dyja anët është me prona private. Si do të rregullohet çështja e këtyre pronarëve ose titullarëve që janë përgjatë lumit, a do t'i mbetet barë Komunës apo Ministrisë qoftë për shpronësim apo për kompensim? Faleminderit!

Sami Behrami (*Udhëheqës i sektorit të zonave për mbojtjen e natyrës*): Faleminderit për pyetjet. Ligji për mbrojtjen e natyrës e parasheh edhe humbjen e vlerave natyrore të zonave të caktuara, të cilat mund të fshihen nga lista e zonave të mbrojtura. Për shembull shumica e monumenteve të natyrës në komunën e Malishevës janë trungje të vjetra, të cilat janë faktor biotik dhe probiotik të cilat mosha e tyre e bënë që edhe nëse shkatërohen, do me thënë vetëvetiu, kemi të drejtë ligji na lejon që ajo zonë mund të fshihet nga zonat e mbrojtura. Në këtë rast për rrjedhën e lumit Mirusha. Pyetja pse është hequr pjesa e epërme e lumit Mirusha? Meqenëse ndërhyrjet në këtë zonë janë shumë, në këtë aspekt ne mbrojmë vlera natyrore, nuk mbrojmë vlera antropogjene. Pjesa prej Banjës deri nën Malishevë deri te diga, ka marrë më tepër karakter antropogjenë të shfrytëzimit të zonës sesa vlera natyrore. Kjo është e bazuar edhe në elaboratin e cila ka qenë në diskutim publik dhe aty janë dhënë arsyetimet se si pasojë e faktorit antropogjen kanë humbur shumë bimë të rralla. Sipas ligjit për mbrojtjen e ujërave çdo lumë duhet t'i ketë në dy anët 15 metra zona të mbrojtura. Kategoria e cila është shpallur si monument për mbrojtjen e natyrës, nuk i kufizonë pronarët në shfrytëzim asgjë, ata mund t'i punojnë. Në rast të ndërtimeve dhe të ndërhyrjeve duhet me pasë projekt konkret dhe leje për ndërhyrje në atë zonë. Sa i përket fatit të liqenit, unë nuk e di se çfarë do të bëhet me të. Ata të cilët e kanë ndërtuar duhet me pasë arsyeshmëri. Ligji për mbrojtjen e ujërave ka kufizime, të cilat rregullohen rrjedhat të cilat nuk janë vlera natyrore do me thënë edhe në qoftë se ne e kemi lënë pjesën prej Banjës deri te Mirusha e kemi hequr prej statusit të mbrojtjes së zonave, nuk do me thënë që ju të bëni çfarë të dëshironi aty, sepse duhet respektuar ligjet për mbrojtjen e ujërave. Për pronësi private për shpronësimin e kompenzim në rast se banorëve nuk ju cenohet e drejta në përdorim nuk ka nevojë as për shpronësim dhe as për kompensim. Faleminderit!

Enver Hoti (GP. AAK): Sikur janë duke u legjitimuar ndërhyrjet, duke i shkatëruar atë që na ka krijuar, dhuruar natyra, fatëkeqësisht jemi duke i legjitimuar. Ju e dhatë një përgjigje të çuditshme te pjesa e mbrojtjes se nëse dikush shkon aty ndërhyn ose ndërton diçka, ju nuk e përcaktuat se kush çfarë duhet me ndërmarrë.Vetëm sa ma forcove edhe më shumë bindjen time që mos ta votoj. Ju bëj thirrje të gjithë asambleistëve që mos ta votojnë!

Fatmir Ademaj (Kryesues i Kuvendit): Atëherë e hedhim në votim. Kush është **për**?
Kryuesuesi i Kuvendit konstatoi se *me shumicë votash* u miratua kërkesa e Drejtorisë për Urbanizëm nr.05/266, dt.01.06.2026, për marrjen e pëlqimit për harmonizimin e vendimit sipas Ligjit për Mbrojtjen e Natyrës dhe vënien nën mbrojtje të Monumentit të Natyrës "Rrjedha e lumit Mirusha" konform propozimit profesional të Grupit punues.
Rezultati i votimit:18 **për**,1 **kundër**, 0 abstenime.

4)Shqyrtimi i parashtresës së Kryetarit të Komunës nr.01/1599, dt.15.09.2026, në lidhje me kërkesën e Drejtorisë për Urbanizëm për inicimin e hartimit të Planit Zhvillimor Komunal 2027-2035 dhe Hartës Zonale të Komunës së Malishevës.

Fatmir Ademaj (Kryesues i Kuvendit): Fjalën ia kaloj drejtorit për Urbanizëm.

Avdi Morina (Drejtor për Urbanizëm): Plani Zhvillimor përfundon në vitin 2027-të dhe ne duhet të jemi të gatshëm të hartojmë Planin e ri Zhvillimor Komunal e njëkohësisht së bashku me të edhe Hartën Zonale të Komunës. Hartat Zonale nuk janë miratuar asnjëherë nga ana e Ministrisë së Mjedisit, për këtë arsyeje ne kemi filluar me procedurat që të kemi një dokument shumë të rëndësishëm, i cili normalisht që formohet me një komision, i cili planifikonë zhvillim dhe mundësi. Për këtë arsyeje ju bëj thirrje që të merren dy vendime të cilat janë: vendimi për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal 2027-2035 dhe njëkohësisht të nxjerret vendimi për: hartimin e Hartës së re Zonale të Komunës së Malishevës për vitin 2027-2035.

Halil Morina (GP. NISMA): Ne i kemi dy dokumente shumë të rëndësishme të cilat deteriminojnë pothuajse për dhjetë vjetët e ardhshme. Ne e kemi pasur një Plan Zhvillimor të cilën e kemi votuar në vitin 2019, shpeshherë ky plan është bërë pengesë, sepse nuk janë parashikuar të bëhen shumë gjëra dhe MAPL-ja. Na ka kthyer për shkak që nuk është në përputhje me Planin Zhvillimore Komunal. Prandaj është e domosdoshme që të marrim procedura sot, të marrim miratim për nisjen e procedurave për hartimin e dy dokumenteve të rëndësishme. Këto dy dokumente janë shumë të rëndësishme të cilat duhet me pasur kujdes që mos me na shkaktuar probleme për dhjetë vitet e ardhshme. Ai komision i cili merret me hartimin e këtyre dy dokumenteve duhet me bërë një punës serioze të ketë parasysh një mori çështjesh, në mënyrë që mos të na dalin pengesa pastaj për realizimin e zhvillimit të komunës së Malishevës.Të gjithë akterët brenda komunës duhet me u marrë me këtë çështje në bashkëpunim me çdo organizatë e individ jashtë këtij objekti, në mënyrë që të hartojmë një Plan Zhvillimor ashtu siç duhet dhe Harta Zonale të sakta në mënyrë që mos me na shkaktuar pengesa për zhvillimin e komunës sonë.

Burim Paçarizi (GP.PDK): Drejtor falëminderit për prezantimin. Jemi duke folur për dy dokumente të rëndësishme. Plani Zhvillimor Komunal do me thënë s'e di do të zhvillohet qyteti i Malishevës për dhjetë vitet e ardhshme. Kjo pikë ndërlidhet me pikën të cilën e patëm më herët me mbrojtjen e natyrës, mënyrën sesi do të zhvillohet turizmi. Nevojitet një ekipë profesionale në mënyrë që të kemi një plan, i cili për dhjetë vitet e ardhshme qytetin e Malishevës e bën një qytet atraktiv më të vizituar si dhe më të zhvilluar ekonomikisht. Kjo duhet me një politikë dhe me një plan të mirëfilltë e strategjik për me zhvilluar komunën tonë. Ne i dimë pengesat të cilat i kemi në vazhdimësi me Hartat Zonale, besoj që secili prej neve i ka vërejtjet e veta për ndërtimet të cilat janë duke u bërë, ne do të mbështesim Planin Zhvillimor Komunal dhe aty ku ka nevojë do të japim sygjerimet dhe vërejtjet e tona, në mënyrë që këto dy dokumente për dhjetë vitet e ardhshme Plani Zhvillimor Komunal dhe Hartat Zonale të Komunës të miratohen edhe nga Ministria

e Planifikimit Hapësinor të jenë aktive që të kenë mundësi të zhvillimit të drejtë dhe të mirëfilltë të qytetit tonë, dhe mos të kemi elemente siç janë duke ndodhur në vazhdimësi duke ndërtuar ndërtesa të mëdha pa pasur hapësira publike që ata qytetarë nuk kanë mundësi për rekreacion dhe për të ndenjur. Unë kisha propozuar që derisa të përfundon ky Plan Zhvillimor, pjesa e ndërtimeve që është duke u bërë të këtë mundësi të zvogëlohet numri i ndërtimit të tyre dhe të kemi mundësi me bërë harmonizimin me Planin Zhvillimor të ardhshëm Komunal.

Veton Zogaj (GP. LVVA): Sa i përket Planit Zhvillimor Komunal dhe Hartave Zonale të Komunës, unë e kam një dilemë. A është duke u bërë fjalë për Hartimin e ri Zhvillimor apo është ndryshim plotësim i Planit Zhvillimor paraprak? Në aspektin juridik ndoshta më mirë është me quajtuar plotësim ndryshim i Planit paraprak në mënyrë që mos të përjashtohet komplet ai dokument, mbi bazën e të cilës është zhvilluar. Unë pajtohem me parafolësit e mi dhe kërkoj nga Drejtoria e Urbanizmit dhe Kryetari i Komunës që në krijimin e Grupit punues për hartimin e këtyre dy dokumenteve shumë të rëndësishme për komunën e Malishevës, t'i ofrojë ekspertët më të mirë të këtyre fushave. Unë e di që komuna e Malishevës ka inxhinierë të ndërtimit dhe ekspert të ndryshëm të cilët mund të japin kontributin e tyre për hartimin e këtyre dy dokumenteve të rëndësishme. Herën e kaluar Plani Zhvillimor është përpiluar nga zyrtarë komunal të fushave të ndryshme të cilët fare nuk kanë pasur ide në lidhje me këto dokumente. E lus drejtorin e urbanizmit dhe i bashkohem fjalimit të z.Burimit që deri në kohën kur të përfundohen këto dy dokumente, ndoshta do të ishte mirë me u pezulluar lejet e ndërtimit sidomos për ndërtimet e larta. A ka ndonjë ekspertizë prej ekspertëve të fushave, që e lejon ndërtimin e ndërtesave mbi dhjetë katëshe, siç është duke ndodhur në Malishevë? A e përballon zona jonë në territorin e saj këtë ndërtim? Do të ishte mirë të kenë edhe afat kohor, Drejtoria e Urbanizimit kur i përfundon këto dy projekte? Kur është afati që ne duhet miratuar në Kuvend, këto dy projekte? Faleminderit shumë!

Enver Hoti (GP.AAK): Drejtor a keni paraparë se kur do të mbyllet faza e planifikimit? Për hartimin e këtyre dy dokumente të rëndësishme, ju lutem zgjedhni njerëzit që e japin kontributin e tyre në mënyrë profesionale. Unë do ta mbështes.

Avdi Morina (Drejtor për Urbanizëm): Ne kemi pasur problem me nënstacionin për energji elektrike ku nuk kemi qenë të pajisur me dokumente për shkak që nuk ka qenë në Planin Zhvillimor në të kaluarën. Ideja jonë është që tani ne me filluar sa më shpejt me punimin e këtyre planeve sepse kemi pasur edhe dëgjime publike në secilin vendbanim të komunës së Malishevës. Unë pajtohem plotësisht me juve dhe pres që të na ndihmoni, sepse këto dy dokumente janë shumë të rëndësishme për komunën. Ju falënderoj shumë për bashkëpunimin.

Burim Paçarizi (GP.PDK): Unë thashë që do ta japim kontributin tonë, por e kam edhe një sygjerim që këto Harta Zonale të zgjerohen edhe në fshatin Mirushë, Carrallukë, Dragobil dhe Banjë, sepse është pjesa aktive e qytetit. E kam një kërkesë te drejtori, ekipa punuese e cila do të jetë ta përfshijë zgjerimin e Hartave Zonale sepse është e domosdoshme dhe e nevojshme për zhvillimin ekonomik, social dhe kulturor për qytetin. Faleminderit.

Avdi Morina (Drejtor për Urbanizëm): Në bazë të Planit Zhvillimor Komunal dhe Hartave Zonale të cilën e parashohim nuk do të përfshihen vetëm zonat e caktuara, por do të përfshihen të gjitha zonat e territorit të komunës së Malishevës.

Enver Hoti (GP. AAK): Ne tani jemi në një fazë të re të Planit Zhvillimor Komunale dhe të Hartave Zonale. A është menduar drejtor a mundet me qenë ndonjë lloj përplasjeje në mes atyre vendimeve, nëse tani marrim masa të veçanta, nëse jepim prona duke filluar nga zona që mundet me qenë zonë kadastrale e qytetit e deri në fshatra? Unë kisha propozuar që ai vendim që u bë me u pezulluar deri sa të realizohet një hartimi i ri i Planit Zhvillimor dhe i Hartave Zonale.

Avdi Morina (Drejtor për Urbanizëm): Në shkresë e keni që Plani Zhvillimor e ka statusin për gjendjen e pronave, normalisht që do të ketë dëgjime publike dhe do të trajtohen secila ndarasë, dhe në bazë të veprimeve që ekzistojnë do të trajtohen Plani Zhvillimor dhe Hartat Zonale.

Fatmir Ademaj (Kryesues i Kuvendit): Në këtë rast i kemi dy votime. Kush është për inicimin e hartimit të Planit Zhvillimor Komunal për vitin 2027-2035? Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se me vota unanime u miratuar kërkesa e Drejtorisë së Urbanizmit për inicimin e hartimit të Planit Zhvillimor Komunal për vitin 2027-2035.
Rezultati i votimit: 24 **për**, 0 **kundër**, 0 **abstenime**.

Fatmir Ademaj (Kryesues i Kuvendit): E kemi edhe kërkesën e dytë. Kush është për inicimin e hartimit të Hartave Zonale të Komunës së Malishevës? Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se me vota unanime u miratuar kërkesa e Drejtorisë së Urbanizmit për inicimin e hartimit të Hartave Zonale të Komunës së Malishevës.
Rezultati i votimit: 24 **për**, 0 **kundër**, 0 **abstenime.**

5) Shqyrtimi dhe miratimi i draftbuxhetit për Komunën e Malishevës 2027/2029, me theks të veçantë për vitin 2027, nr.04/481, dt.31.08.2026.

Fatmir Ademaj (Kryesues i Kuvendit): Fjalën ia kaloj Kryetarit të Komunës ***z.Ekrem Kastrati.***

Ekrem Kastrati (Kryetar i Komunës): I nderuar Kryesues, të nderuar këshilltarë komunal, ju të pranishëm dhe qytetarë që po na ndiqni përmes kanaleve të mediave! Ky muaj shtator sigurisht që u theksua me deklaratën tonë të përbashkët lidhur me një vendim skandaloz që ka ndodhur në Dhomat e Specializuara me selinë në Hagë. Ky dënim nuk përçon vullnetin e qytetarëve dhe popullit të Kosovës, prandaj edhe unë si Kryetar i Komunës së bashku me të gjithë juve ju falëminderit që jemi bashkë në mbrojtje të vlerave tona historike, në mbrojtje të atdheut, lirisë dhe pavarësisë, ndaj ju shpreh mirënjohje dhe falënderim në emrin tim.

Kur janë në pyetje vlerat tona të përbashkëta, liria, pavarësia, dhe mbrotja e historisë duhet të jemi të gjithë së bashku.Të nderuar këshilltarë komunal mbledhja e sotme është e një rëndësie e veçantë për të gjithë qytetarët tanë, ju e keni pranuar materialin me të cilën potencohet që komuna e Malishevës për vitin 2027 e ka një buxhet në vlerën prej **23.161.855 €** që në krahasim me vitin e kalaur e kemi një buxhet mbi ***1.73.145 €*** më të lartë, mirëpo kjo rritje sado e vogël ndikon në kategorinë e pagave shtesave dhe të hyrave vetanake. Pra dëshiroj ta theksoj për ju dhe qytetarët se ky buxhet ka për qëllim zhvillimin ekonomik, vazhdimin e investimeve në qendra dhe në fshatra dhe gjithnjë në fuksion të jetësimit të projektit tonë të përbashkët për Malishevën Urbane dhe tashmë në fshatra urbane për të cilën na kanë dhënë besim qytetarët e komunës sonë. Në buxhetin për vitin 2027 nga grandi qeveritar janë planifikuar ***21.90.172 €*** dhe nga të hyrat vetnake ***2.71.683 €*** në rritje të hyrave vetanake prej ***127.735.00 €*** të shpërndara në pesë kategori ekonomike. Në kategorinë e *pagave dhe shtesave* janë të planifikuara 13.495.393 € e cila ka të bëjë për 1,386 punëtorë të punësuar. Në kategorinë e *mallrave dhe shërbimeve* janë dedikuar 2.900.000 €. Në kategorinë e *shpenzimeve komunale* janë 550.000.00 €.Në kategorinë e *subvencioneve* i kemi të planifikuara 600.000.00 € si dhe kategoria e fundit, por mjaftë e rëndësishme për zhvillimin e komunës tonë është kategoria e *investimeve kapitale* të cilat janë 5.616.460,00 € që krahasuar me vitin aktual kemi rreth 261.000.00 € më shumë. Pjesa më e madhe e buxhetit të komunës është e ndarë në tri programe kryesore, në programin *për arsim*; *shëndetësi;* si dhe programin për *administratë komunale*.

Të nderuar, ky projekt buxhet është me modifikime shumë të vogla sepse jemi të vetëdijshëm që një pjesë e madhe kryesisht e mjeteve për investime kapitale janë të parapara për infrastrukturë rrugore nëpër fshatrat e komunës së Malishevës dhe në qendër të qytetit: kanalizime e ndriqim publik, dhe investime të tjera kapitale në sektor të ndryshëm. Unë shpreh gatishmërinë time si Kryetar i Komunës që do të jem i gatshëm që kërkesat tuaja për projekte që janë me interes të përgjithshëm do t'i përkrahim. Jam plotësisht i vetëdijshëm që nevojat dhe kërkesat e qytetarëve janë më të mëdha dhe kanë nevojë për përkrahje, por ne i kemi mundësitë buxhetore të kufizuara. Komuna jonë njëjtë sikur edhe disa komuna të tjera është duke u ballafaqur me detyrimet që kanë dalë nga Kontrata Kolektive. Që nga viti 2023 komunës sonë iu kanë marrë rreth 5.5000.000,00 € të cilat pastaj e kanë destabilizuar rrjedhën e punimeve për projektet. Ju sigurojë që për asnjë moment nuk do të ndalemi për shumë projekte që janë në interes për qytetarët e komunës tonë, nëse ne si komunë nuk do t'i kemi mundësitë tona buxhetore për t'i plotësuar do t'i drejtohem programit të institucioneve qendrore, duke mos i lënë anash donatorët dhe partnerët tanë ndërkombëtarë. Prandaj duke e pasur në konsideratë që miratimi i buxhetit është obligimi i jonë ligjor, kërkoj nga ju që pas kontributeve që mund ta jepni në këtë seancë, në fund të përkrahni hartimin e këtij projektbuxheti të komunës së Malishevës për vitin 2027-2029 me theks të veçantë pët vitin 2027. Faleminderit shumë për vëmendjen dhe konsideratën tuaj!

Fatmir Ademaj (Kryesues i Kuvendit): Faleminderit shumë kryetar ***z,Ekrem Kastrati.*** Tani hapi debatin për këtë pikë të rendit të ditës.

Valjeta Hoti (GP.PDK): Faleminderit Kryetar për elaborimin, sigurisht projektbuxheti është një ndër dokumentet më të rëndësishme të komunës dhe në kuadër të tij, kuptohet se ku do të shpenzohen mjetet e komunës sonë. Unë do të filloj me një pyetje që vjen prej rekomandimit të rrjetit të grave të Kosovës, besoj që edhe ju jeni në dijeni me të, sigurisht që edhe koleget asambleiste janë në dijeni, të cilat do t'i përmendi disa prej tyre: është financimi i mjaftueshëm i Qendrës për Punë Sociale, punonjës shtesë, fondi emergjent për rastet që trajtohen në Stacione Policore dhe në qendra për Punë Sociale. Subvencionet dhe grandet që janë të dedikuara në veçanti për gratë, po ashtu u përmend edhe transporti publik në zonat rurale. Dëshiroj me ditur a i keni pasur parasysh këto rekomandime dhe cilat kategori janë të përfshiera? Dëshirojë të ndalem në veçanti te financimi i investimeve kapitale, veçmas janë dy projekte të cilat po na përsëritën vazhdimisht siç është ndërtimi i shkollës në Turiakë e që në projekte të ndryshme vazhdimisht kemi hasur me shuma të ndryshme. Për shembull në projektbuxhetin e vitit 2023-2025, projekt që na ka ardhur në vitin 2022 për miratim, është parashikuar në shumën prej 265.000.00 €; pastaj i njëjti na ka ardhur me shumën prej 192.000.00 €; pastaj ka qenë shuma 100.000.00 € do me thënë që prapë te pjesa për arsim dhe shkencë shumën totale e ke komplet prej 254.000.00 €, ndërsa vetëm për këtë shkollë i keni të ndara vetëm 100.000.00 €. Në të njëjtin rast është edhe me kolektorin e ujërave të zeza faza një në Lumishtë prej 2.5 km, do me thënë këtu janë edhe dy prej projekteve edhe raporti i auditorit t'i ka konsideruar që janë projekte që po përsëritën vazhdimisht edhe sipas tij ndërtimi i shkollës në Turiakë, është dashur me përfunduar më 29 gusht të vitit 2024, ndërsa kolektori i ujërave të zeza është dashuar me përfunduar më 10 nëntor të vitit 2025, meqenëse janë të përfshiera përsësri në projektbuxhet. A janë zbatuar rekomandimet e auditorit për këto dy projekte dhe sa ka një afat real për realizimin e tyre? Në mënyrë që ne si Kuvend por edhe qytetarët e Malishevës të kenë mundësi t'i shohin rezultatin e këtyre projekteve, sepse vazhdimisht po na bie me i përsëritur gjërat e njëjta. Që nga viti 2021 projektbuxhetet sillen rreth të njëjtave projekte ke raste me renovime, me asfaltimin e rrugëve që vazhdimisht përmenden të njëjtat. Faleminderit!

Burim Paçarizi (GP. PDK): Unë i kam dy pyetje: e para lidhet me monumentin e Sheshit të Dëshmorëve në Malishevë, sa është vlera për me u mbyll kjo kontratë? Sa kanë mbetur borxh ndaj atij operatori ta kemi një përgjigje të saktë edhe sa obligime kanë mbetur te ky projekt? Ndërsa pyetja tjetër lidhet me rrugët anësore të lumit Mirusha, prej urës deri te qendra e tranzitit, Kryetar jam duke e parë që është në planifikim. Çfarë ka ndodhur me investimet e kaluara, që janë bërë te dy pjesët anësore të lumit Mirusha? Ne e dimë që ka pasur investime dhe janë prishur ato investime tani prapë janë në planifikim. A do të jenë tani investimet finale dhe çfarë ka ndodhur me investimet e më herëshme?

Veton Zogaj (GP. LVV): Faleminderit i nderuar Kryetar për paraqitjen e draftbuxhetit. Unë në mbledhjen e KPF-së nuk kam diskutuar, mirëpo sot më duhet t'i përmend disa projekte të cilat prej mandatit të parë si asambleistë e tani po vazhdoj ende me i parë në draftbuxhet, të cilat asnjëherë nuk po marrin dritën jeshile që kanë përfunduar.

E para është monumenti i Sheshit të Dëshmorëve në Malishevë, Kryetar nëse keni mundësi me na dhënë një shpjegim konkrret. Për çfarë bëhet fjalë sepse është një shumë e madhe që kërkohet në vlerën prej 470.000.00 €. A është borxh i mbetur, apo ka me u ndërtuar diçka tjetër? Me sa di unë projekti është i përfunduar, tani më është në përdorim të qytetarëve. Çfarë është duke ndodhur me shumën prej 470,000.00€? Pastaj e kemi kolektorin faza e parë, Bubël – Lumishtë shuma prej 394.000.00€ prapë janë kërkuar ky projekt kush do që ka qenë asambleistë herën e kaluar e dinë, që ky projekt për kanalizim është në vazhdimësi në buxhetin një herë janë ndarë 100.000.00€, herën tjetër 200.000.00 €, shuma tepër të mëdha dhe asnjëherë nuk zhvillohen punime aty. Ku shkojnë këto mjete? Në rrugët anësore të lumit Mirusha janë kërkuar 250.000 € dhe janë zhvilluar punimet në vazhdimësi dhe përsëri kërkohet me intervenuar në këtë pjesë në shumën prej 250.000.00 €, shto edhe 50.000.00 € për ndërtimin e urës, minitranzitit do me thënë me na dhënë një shpejgim konkrret. Çfarë është duke ndodhur, pse po kërkohet prapë projekt të cilat ka vite të tëra që kanë filluar të realizohen? Për shtratin e lumit Mirusha për dy rrugët anësore janë kërkuar 150.000.00 € për intervenim apo mjete shtesë.
Rruga, kanalizimi, ndriçimi në lagjen Mirëdia 156.000.00 €, ndërsa pak më poshtë në tabelën për investime kapitale për një mori të fshatrave tona pothuajse për të gjitha fshatrat e komunës së Malishevës dedikohen 18.000.00 € ose 100.000.00 € nevojiten për intervenim në kanalizim për një pjesë të cilën ne e dimë të gjithë sa është lagjja Mirëdita nevojten 156.000.00 €, ndërsa për krejt fshatrat e komunës së Malishevës nevojiten 100.000.00 €. E kemi sistemin e ujësjellësit në fshatra shumën prej 100.000.00 €, kërkoj pra një përgjigje konkrrete. Çka synohet me shumën prej 100.000.00 € në sistemin e ujësjellësit, sepse ne kemi gypa gjithandej mirëpo nuk kemi ujë, ndërsa nevojitet kjo shumë e cila është e papërfillshme ose i largojmë këto 100.000.00 € i caktojmë për një projekt tjetër. Pastaj e kemi një projekt këtu asfalltimi i rrugëve në fshatra: Ngucat, Kravasari, Llapqevë, Mirushë, Turiakë, Astrazub, Rud, Panorc, Pagarushë janë më shumë se gjysma e fshatrave shuma që nevojitet për punën është 18.000.00 €. Çfarë keni të bëni me këtë vlerë, cilat rrugë mund me u shtruar në shumën e vlerës prej18.000.00 €? Pa dashur me qenë skeptik dhe me dyshuar në ato projekte, mirëpo kur jam duke i parë këto shifra për realizimin e projekteve në terren më vë në dyshim. Do të ishte mirë me na treguar për pyetjet të cilat i parshtrova, për Sheshin e Dëshmorëve 470.000.00 €, kolektorin mbi 300,000.00 € dhe për projektet e tjera të cilat nuk po marrin epilog përfundimtar. A jemi me borxhe si komunë, apo pse po nevojitën mjete shtesë? Faleminderit shumë!

Halil Morina (GP.NISMA): Kryetar faleminderit që na laborove këtë dokument kaq të rëndësishëm. Unë do t'i jap disa vlerësime të përgjithshme, ne e kemi një buxhet prej 23.000.000.00 € i cili as për së afërimi nuk i plotëson kërkesat dhe nevojat e qytetarëve të komunës së Malishevës, duke ia shtuar këtu edhe me pasojat që kemi me u përballur për vitin 2026 me përmbaruesin, tregon që komuna jonë është në një krizë të thellë financiare.Të gjitha komunat kanë probleme me përmbarues, mirëpo ne si komunë e varfër i kemi pasojat shumë më të mëdha në krahasim me komunat e tjera. Prandaj këto janë mundësitë e tona financiare, nuk kemi mundësi me i rritë, detyrë e jona është që këto pak mundësi tona financiare që i kemi me i kanalizuar në

mënyrë e duhur, që me i kryer disa prej nevojave më emërgjente që i kanë qytetarët e komunës së Malishevës. Për mua është e rëndësishme që në përgjithësi, në vija të trasha, ekzekutivi është munduar t'i përfshijë dhe shpërndarë këto mjete në nevojat më emërgjente, infrastrukturore kur flasim për investime kapitale, kemi rregullimin e rrugëve që i lidh fshatrat mes vete, asfalltim i rrugicave, kanalizime e gjëra të ngjajshme. Kur ne i analizojmë të gjitha programet në shëndetësi,arsim,subvencione ne e dim që shumë sektor kanë nevojë për subvencionim,prej bujqësisë, arsimit, kulturë, studentë, sport dhe ajo shumë prej 600.000.00 € është shumë e vogël, nuk mundemi me zhvilluar bujqësinë me 200.000.00 € subvencionim kur e dimë që komuna jonë është një zonë kryesisht blektorale dhe nevoja për investim në blektori do të shkaktojë zhvillim ekonomik në komunën e Malishevës. Mirëpo, unë e inkurajojë Kryetarin e Komunës që së bashku me stafin e tij që të vazhdojë e të kërkojë mbështetje financiare që t'i ndihmojë këtij buxheti të varfër që e kemi. Në të kaluarën ekzekutivi ka realizuar bashkëpunime me organizata të ndryshme ndërkombëtare humanitare e falë bashkëpunimit ne kemi fituar miliona euro për subvencionim nga këto organizata. Unë ju inkurajojë që të vazhdoni prapë bashkëpunimin me organizatën që i kemi pasur deri tani siç është ajo e "Qatar CharityIslamic" "Relief Kosova" dhe me organizatat e tjera të cilat kanë me i ndihmuar bujqësisë dhe sektorëve të tjerë të komunës së Malishevës. Ne i ngritëm shumë shqetësime para rendit të ditës dhe në shumicën e tyre mundemi me i realizuar duke e ngritur dorën në mënyrë unanime për këtë projektbuxhet. Unë nuk e them që ky projekt nuk ka vërejtje, mirëpo ky është vetëm një projeksion mbi të ardhurat dhe shpenzimet dhe nuk është fundi i saj, shpresoj ato të cilat i kemi në këtë projektbuxhet mos të na përsëriten vitin e ardhshëm, shpresojë të t'i përfundojmë ato obligime të cilat i kemi njëherë e mirë dhe pas këtyre projekteve të vazhdojmë me projekte të reja. Faleminderit!

Hafir Rexha (GP. NISMA): Kryetar ju përgëzojë për elaborimin e projektbuxhetit me theks të veçantë për vitin 2027. Nevojat e qytetarëve janë shumë më të mëdha, por arsyet vetëm i potencuat. Por unë dola këtu me një kërkesë pak më të veçantë. Në buxhet e vërejta që është përfshirë renovimi i rrugës, Lumishtë-Turiak-Panorc është rrugë e cila e lidh komunën e Malishevës në trekëndëshin Klinë-Gjakovë-Rahovec. Kjo rrugë ka më së shumti nevojë. Unë kisha propozuar që të gjitha kanë prioritet por kjo të jetë prioritet i prioriteteve, sepse ajo rrugë është bërë e pakalueshm. Ju përgëzoj për këtë iniciativë që e keni future në projektbuxhet, por njëkohësisht kërkoj që kjo të jetë prioritet i prioriteteve. Faleminderit!

Fitim Shala (GP. LDK): Faleminderit Kryetar për elaborimin e projektbuxhetit për vitin 2027. Fillimisht Kryetar kisha kërkuar prej juve që ju prej drejtorëve komunal me kërkuar më tepër llogari se ku jemi me procedurat për ekzekutimin e projekteve që i kemi votuar në buxhet për t'i realizuar për vitin 2026, sepse sinqerisht është bërë e tepërt që ne kemi dy e tri projekte që i kemi propozuar për buxhet dhe ende nuk janë ekzekutuar, ka rrugë që nga viti 2023. Në Ngucat është marrë vendim për asfalltim dhe ende nuk është asfalltuar. Ne kuptojmë rëndësinë e buxhetit dhe e kemi parasysh që ky buxhet nuk është shkop magjik për t'i zgjidhur të gjitha problemet e qytetarëve të komunës sonë, por aty ku janë mundësitë me kërkuar më shumë prej drejtorëve dhe

me iu qëndruar më tepër gati kërkesave për realizimin e projekteve që ne si asambleistë i votojmë në buxhet. Ky projektbuxhet do ta ketë mbështetjen e grupit parlamentar të LDK-së dhe urojmë që këto projekte të realizohen ashtu siç janë parashikuar.

Enver Hoti (GP. AAK): Faleminderit Kryetar për elabormin e projektbuxhetit.Të gjithë jemi të vetëdijshëm që këto janë mundësitë buxhetore dhe nuk ka mundësi me i zgjeruar më tepër ato se sa janë, por janë duke u shtruar pyetje që janë reale dhe të përsëritshme, të cilat po kanë ndikim në zhvillimet të mëtutjeshm të komunës sonë. Vazhdimisht jemi duke dëgjuar për penalizime nga përmbaruesit. A keni ndërmarrë diçka? Ne nuk e pamë në këtë planifikim, një masë që do ta nxjerrte komunën tonë nga kjo situatë, qoftë për Kontrata Kolektive, sepse disa komuna kanë bërë disa zgjidhje është mirë me i marrë shembujt dhe praktikat e mira. Janë edhe disa penalizime të tjera të cilat janë përmendur që unë nuk e di sa është vlera e tyre dhe nuk e di shkakun pse kanë ardhur deri aty te intervenimet e institucioneve tjera përmes mekanizmave gjyqësore. Sa është vlera e tyre? Mendoj që kjo senacë është dashur me u zgjatur edhe me një seancë tjetër, sepse kemi me i sqaruar disa çështje që kenë të bëjmë me buxhetin me një planifikim buxhetor deri në mandatin për vitin 2029. Dëshiroj me ngritur edhe një çështjen e Sheshit të Dëshmorëve është cekur shuma prej 450.000.00 €. Çfarë do të bëhet, a ka ndonjë plan apo vetëm është ofruar një shifër. U përmend disa here projketi për Malishevën urbane, mirëpo kur parashihet të përfundojë? Sepse për këtë projekt janë shpenzuar me miliona euro. Ne i kemi parë disa prerje të shiritave të cilat kanë qenë shumë bukur mirëpo një përfundim duhet me pasë. Këtu kemi shumë të dhëna që janë nisur projektet mirëpo shpeshherë kanë mbetur në gjysmë, ato projekte kanë mbetur në inicim dhe është kryer një fazë e punës, nuk janë realizuar deri në fund dhe prapë ato duhet me filluar nga pika zero që është humbje buxhetore. Për besë ndihem keq kur e dini që gjatë fushatave elektorale në vitin 2025 ka shkuar për premtimin për ujë dhe tani janë cekuar 200.000.00 €. Cili është investimi real për ngritjen e kapacitetit të ujit në Malishevë, kur e dini që ka edhe humbje të ujit në systemin aktual? Kjo me të vërtetë është për keqardhje. Kemi dëgjuar Kijeva urbane, në këtë projektbuxhet nuk ekziston asnjë shkronjë për Kijevën urbane, nuk ka asnjë investim. A ka ndonjë planifikim esencial që ka të bëjë me qytetarët e zonës së Kijevës që janë përafërsishtë njëzetë fshatra? Në këtë deklarimin tonin që janë fituar votat për Kijevën urbane. Çerdhet që priten me u funksionalizuar a do të hyjnë në programin e të punësuarve? Unë e kam një propozim konkrret, të cilën e ngriti edhe znj.Valjeta. Kërkesa e cila ka ardhur nga rrjeti i grave, të futet në planifikimin buxhetor sepse është në interes të funksionimit dhe të kujdesit të një shoqerie e cila për çdo ditë është më e atakuara dhe më e adaptuara që kemi të bëjmë me ngjarjet si rastet sociale, problemet familjare, funksionimi i qendrës sociale, të cilat i ka paraqitur drejtori dhe ne i kemi mbështetur. dhe do të vazhdojmë prapë me i mbështetur. Pra, mendoj që duhet me ju gjetur një hapsirë buxhetore Kryetar, pra ta mbështesim funksionimin e qendrës sociale ashtu siç e kanë parashikuar dhe unë e falënderoj grupin e rrejtit të grave që është kujdesur dhe ka vendosur temën shumë të rëndësishme për qytetarët. Edhe njëherë jam duke kërkuar që ta shqyrtoni mirë këtë projektbuxhet për atë që është duke kaluar komuna jonë. Çfarë është duke ndodhur me penalizimet gjyqësore lidhur me masat që janë ndërmarë? Faleminderit!

Vlera Bytyçi (GP. LVV): Faleminderit Kryrtar për elaborimin. Në muajin mars kur është mbajtur seanca e Kuvedit që është votuar buxheti i këtij viti unë kam marrë pjesë, këtë herë dëshirojë me paraqitur një kërkesë, për bursat e studentëve. Komuna e Malishevës që nga viti 2023 nuk ka ndarë bursa për studentë. Ju e pohuat se buxheti këtë vit është më i madh se herën e kaluar. Përderisa viteve të kaluara ka pasur bursa për studentë, pse tani nuk po ka mbështetje për studenta? Drejtori për Shëndetësi z. Amrush Helshani besoj se e di si është gjendja në shoqatën e Hendikosit, është përmendur që ka me u ndërrtuar një objekt për këta persona, unë e kam vizituar atë shoqatë, për mua është e papranueshme sepse aty nuk kanë ujë dhe energji elektrike. Aty nuk nevojitet një buxhet i madh për me ju mundësuar funksionalizimin e asj shoqate, madje edhe punën për kategorinë e atyre personave. Unë sa kam mundur ta vërejë në buxhet është rritur mbështetja për zyrën për barazi gjinore, gjatë takimeve me grupin e grave e kam pasur një kërkesë, është lejimi i shfrytëzimit të buxhetit për grupin e grave, që kryesisht për aktivitetet që i kanë kryer gjatë muajit tetor. Faleminderit!

Bashkim Krasniqi (GP. NISMA): Faleminderit Kryetar për elaborimin e projketbuxhetit. Ky është dokumenti më i rëndësishëm për vitin fiskal 2027. Ne jemi dëshmitarë që është një buxhet minimal për investime sidomos për investime kapitale që janë shumë të nevojshme për fshatra, janë përafërisht 5.600.000,00 € investime kapitale, duke i marrë parasysh edhe problemet që i kanë komunat me Kontratën Kolektive, ndoshta kjo pjesë e kësaj shume zvogëlohet mos të themi përgjysmë, kështu që duhet me u pajtuar me atë që një pjesë e madhe e projekteve nuk munden me u realizuar. Ajo çfarë unë deshta me diskutuar këtu, për të cilën e kam pranuar kërkesën nga bashkësia lokale duke i përfshirë fshatrat e bjeshkës Berishë, duke e përfshierë edhe Fshatin e Ri. Ata e kanë parashtruar një kërkesë me datën 21 korrik 2026 me numër të protokolit 04/409, aty nuk janë përfshi disa projekte të cilat janë jetike, siç është ujësjellësi i fshatit, jo vetëm prejardhjen të cilën e kam edhe unë, por problemet me e ujin e pijes çdo vit janë më të mëdha në Komunën e Malishevës. Kështu që ndoshta është mirë një fshat me përfshi, jo me vendosur 100.000.00 € rregullimi i ujësjellësit nëpër fshatra sepse nuk ka mundësi me u bërë rregullimi i ujësjellësit me 100.000.00 €, por një fshat me përfshi që ka burim të mjaftueshëm dhe atë fshat me përcjellë me ujësjellës, derisa të bëhet zgjidhje më adekuate. Pastaj ka qenë ndërtimi i Kullës Rifat Berisha në Berishë, nuk është në projektbuxhet. Rregullimi i oborrit të shkollës në Fshatin e Ri konkrretisht në shkollën "Rifat Berisha" nuk është në projektbuxhet. Realisht është, por është një shumë, që për të gjithë ato shkolla që janë përfshi është e pamundur të realizohen shuma është 50.000.00 € për vitin 2027 janë përafërsisht shtatë-tetë shkolla për renovimin e oborrit. Për mos të hyrë në detaje të tjera, këto janë disa çështje që unë nuk pajtohem sa i përket grumbullimit të shumë projekteve dhe ndarjes së një shume që nuk është relevante me atë që ka me u punuar. Unë e kam vetëm një kërkesë Kryetar ktheju punës sikur në mandatin e parë që ke punuar dhe uroj që ky projektbuxhet të realizohet në tërësi ashtu siç po shkruan këtu. Faleminderit!

Imran Xhyliqi (GP.PDK): Faleminderit Kryetar për elaborimin e projktbuxhetit. Unë do të ndalem te disa pika të cilat janë të ripërsëritura prapë që nga viti 2026, unë jam duke filluar nga rregullimi i oborrit të komunës që nga viti 2026, ende nuk e kam parë asnjë kockë të rregulluar, apo ndoshta ka kohë deri në fund të vitit 2026? Rregullimi me drunjë në Sheshin e Malishevës janë ndarë 70.000.00 € e që e njëjta shumë është edhe për vitin 2027. Kryetar ose drejtorë për cilën pjesë e keni fjalën? A bëhet fjalë për këtë gjelbërimin që janë mbjellë disa lule, apo për ndonjë pjesë tjetër? A është ripërsëritur shuma 70.000.00 € dy herë si në vitin 2026 njejtë edhe për vitin 2027? Te kodi i projektit 53427 asfalltimi i rrugëve në fshatra, janë përfshi afërishtë pesëmbëdhjetë fshatra me shumën 18.000.00 € për vitin 2027, pastaj janë përfshirë 100.000.00 € renovimi dhe sanimi, asfalltimi i rrugëve. A ka mundësi drejtor të tregoni pse kjo ndarje në tabelën më lart është cekur 18.000.00 €, kurse në tabelën më poshtë 100.000.00 €? Gjithashtu shuma 2.150.000,00 € në akse të tjera, nëse në të gjitha akset i keni përfshirë të gjitha fshatrat dhe lagjet, pse e keni bërë këtë ndarje? Sa i përket ndërtimi të ujësjellësit e vërejta që është përsëritur shuma 100.000.00 € vlera totale që e kemi votuar njëjtë si herën e kaluar për buxhetin për vitin 2026; pastaj e vëretja shumën që është përfshi për asfalltimin e rrugëve nëpër fshatra shumën prej 2.150.000.00 €. Shuma prej 100.000.00 € nuk e di se në cilin vend ka me shkuar kjo shumë për ujësjellës? Nëse ju e bëni shumën rreth pesë milion euro ose sa është për buxhet për tri vitet e ardhshme, nëse e rregullon asfalltin, nëse i shtron kubëzat troturatet dhe pas dy vjete të vjen ujësjellësi i bjen që me prishur të gjithë atë që ke punuar për me shti ujësjellësin, do me thënë i bie punim i dyfishtë. Te kategoria e arsimit e vërejta shumën 254.000.00 € mirëpo asnjë euro nuk është ndarë për bursat e studentëve. Pika e fundit që është pak më e ndjeshme për Organizatat e Veteranëve të Luftës, jam duke e parë që shumica e kolegëve asambleistë nga partia e Nismës, gjithashtu edhe Kryetari i kanë veshur maicat me mbishkrimin "Liria ka Emër". Kryetar në vitin e kaluar dhe as këtë vit nuk e keni ndarë asnjë euro për Organizatën e Veteranëve të Luftës, herën e kalur kërkesa e tyre prej 25.000.00 € nuk u votua. Kështu që do të ishte mirë pak a shumë me i kthyer sytë edhe nga ana financiare dhe jo vetëm nga ana e mediale.

Demir Bajra (GP. PDK): Kryetar unë po ju përgëzoj për projektet për vitin 2027 të cilat janë voluminoze, por rilindasit na kanë lënë mesazhe shumë të mira dhe po marrë një citat shumë të vogël të Sami Frashërit "pa u nisur nga e pakta nuk mund të arrihet te e shumta". Unë me datën 3 dhjetor e kam dhënë betimin si asambleist, dhe kisha dashur me na dhënë një elaborim. Çfarë është punuar në Malishevë që një vit? Ne i kemi edhe dy muaj që i kemi ndarë mjetet me miliona, mbi një milion euro me projekte që i kemi kaluar projektet dhe je një fitues i votës mbi 51%, Kryetar kam dëshirë me qenë racional dhe koperativ në këtë drejtim, jam duke i vërejtur shumat për shkolla, sanim, sanitari, shkolla që janë ndërtuar që dy e tri vjet jam shumë i ndjeshëm kur jam duke i vërejtur, sepse ju keni dhënë mbi gjysmë milion euro, pas dy vitesh me investuar për renovim të shkollës në sanitari për mua është pak deklaratë. E kemi asfalltimin e rrugëve, unë kam pasur fatin me qenë asambleist në vitin 2017 nga rradhët e Nismës, por edhe pa ardhur Nisma, PDK-ja kur ka qenë janë rrugët e bartura gjerë më tani të cilat fare nuk janë asfalltuar, unë kur flas çdoherë dëshirojë me qenë racional dhe të flasim me dokumente dhe me argumente, sepse pa

argumente mundet me u sfiduar. A mendoni që ne anëtarë të PDK-së të cilën e kemi marrë votën për me ardhur këtu nuk kemi dëshirë me votuar projekt buxhetin për vitin 2027-të? Ka anëtarë të Nismas që mendojnë që ne kemi ardhur këtu vetëm si kuklla. Jo nuk është ashtu, Kryetar edhe kozmetika e ka afatin e shkurtër. Kryetar jam duke u nisur vetëm nga fshati që vij aksi i rrugës Lumishtë-Turiakë-Panorc-Rud-Llapqevë për mua jo vetëm si Demir, por si komunitet për të gjithë ato kanë mbetur në gjendje të vështirë. Kryetar unë kam dëshirë me ju parë çdoherë mirë. A do të vetëdisohemi ndonjëherë si shoqëri dhe si pozitë, që po e marrin si drejtorë, apo si kryetar këtu sepse më shumë i ke emëruar si emra si ekzekutiv sesa që ka interesim ekzekutivi i Nismës! Që një vit është duke u parë se çfarë interesimi ke nga ana e drejtorëve e cila është e dhimbëshme, njerëzit ju kanë besuar, Kryetar dikush që ju jep votën për mua është e shenjtë, një Kryetar i cili i merr mbi 50% është i shenjtë. Çka duhet m'i thënë ne komunitetit që jemi që një vit këtu? Pse nuk jeni duke e hapur ekranin aty dhe me pa se çfarë projkete prej 3 dhjetor e gjer më tani, çfarë keni bërë? E kemi ndriçimi publik ato dritat tërë ditën janë të ndezura, por Nisma sigurisht ka mjete të mjaftueshme dhe nuk mirren fare me ato. A ju shkon ndërmend juve si Kryetar dhe këta drejtorë që i ke këtu përballë që marrin paga mbi 1000 € me thënë ndaluni se nuk është gjendja mirë? Me shkua me sanuar atë problem. Jeni duke u thirrur në Kontratën Kolektive është e treta apo e katërta herë Kryetar që ka ende mësues të komunës së Malishevës që nuk kanë marrë pare të Kontratës Kolektive, nuk është më ajo shuma e madhe të cilën e rrezikon Kuvendin e Komunës së Malishevës. Unë jam i pari që tërhiqem mbani mjetet derisa ju ta bëni një zgjidhje. Ju në tablë i keni vendosur devijemet e rrugëve me akse, si me ditë unë me për shembull me akse që i keni shkruar për rrugën në Panorc, si me kuptuar unë, aksin zero, aksin një, si? Kryetar me gjithë respektin që e kam do të kisha votuar projektbuxhetin, mirëpo këtë vit dhe vitin që e lamë pas nuk është meritor, sepse nuk ka bashkëpunim. Kryetar pa bashkëpunuar me partitë opozitare, mos u kënaqni ju Nisma dhe LDK-ja që e votoni sot projektbuxhetin, sepse edhe ne jemi banorë të Malishevës, edhe ne i paguajmë tatimet brenda komunës së Malishevës, sepse ne nuk jemi të ardhur nga Amerika.

Blerim Thaçi (Drejtor për Ekonomi dhe Financa): Përshëndetje për të gjithë! Para juve e prezantoi në vija të trasha Kryetari projektbuxhetin për vitin 2027-2029 me fokus të veçantë për vitin 2027. Pra juve u prezantuan investimet kapitale të cilat do të kryhen brenda tri viteve deri në vitin 2029, dhe disa projekte të cilave iu është shtyer afati i realizimit të cilat u përmend disa prej juve, të cilat kanë ndodhur jo për fajin tone, por për shkak të devijimeve buxhetore me keq klasifikim të vendimeve gjyqësore. Kontrata kolektive është nënshkruar nga niveli qendror dhe neve janë duke na shkaktuar dëme në realizimin e saj që nga viti 2022. Kontrata Kolektive ia ka marë komunës së Malishevës rreth 5.5 milion euro, se kush janë ata mësimëdhënës që i kanë përfituar ne nuk e dimë, sepse neve vetëm na kanë marrë ato mjete, vetëm në këtë vitë i kanë marrë mbi 1.5 milion euro kryesisht mjetet na kanë marrë prej subvencioneve edhe prej komnalive. Te ndërtimi i shkollës në Turiakë kanë mbetur vetëm edhe 100.000.00 € për inplementim për të përfunduar. E përmendën shumica e asambleistëve shumën prej 18.000.00 € për asfalltimin e rrugëve, këto kontrata janë në inplementim dhe vetëm edhe 18.000.00 € kanë mbetur për t'u

përfunduar. Projekti i Sheshit në Malishevë ka përfunduar. Monumenti është një projekt i ri i cili është planifikuar në vitin 2026 që është parashikuar të përfundojë në vitin 2027-2028, projekti është monumineti i dëshmorëve i cili do të vendoset në Sheshin e Dëshmorëve. Planifimi i rrugëve që është parashikuar për tri vjet është mbi tetë milion euro, kjo kërkesë ka ardhur nga drejtoria e urbanizimit dhe me arsye se janë rrugë të pashtruara dhe të paemëruara nuk kanë emërim. E përmendi edhe z.Enveri Kijevën edhe aty janë gjashtë akse të cilat do të rregullohen gjashtë rrugë.Te çështja e planifikimit të stafit për çerdhet po ju njoftojë që kërkesa e Asamblesë ka shkuar në MAPL,mirëpo edhe kërkesa e DKA-së ka shkuar në Ministrinë e Arsimit, mirëpo dapartamenti i buxhetit në komisionin parlamentar për buxhet dhe financa. Asnjë përfaqësues i Ministrisë së Arsimit nuk ka shkuar dhe ne e kemi bërë kërkesën sipas planifikimit të buxhetit si drejtori e financave duke ju drejtuar komisionit parlamentar që me amandamentim të ligjit kur të shqyrtohet buxheti në parlament të rritet numri i stafit të punëtorëve sepse për vitin 2027 i kemi shtatë zyrtar për çerdhen e të rriturve.

Vlera Bytyçi (GP. LVV): Cila është arsyeja që janë vetëm shtatë?

Blerim Thaçi (Drejtor për Ekonomi dhe Financa): Arsyeja që mundem me thënë është shumë e pakuptimtë. Dapartamenti i buxhetit na ka thënë duke pasur parasysh kërkesat që i paraqesin nga Drejtoria e Financave dhe sipas njoftimeve jozyrtare që janë duke u ndërtuar çerdhet kemi planifikuar atë, pa asnjë kërkesë që me u mbështetur dikun. Rrugët anësore të lumit Mirusha janë planifikuar për vitin 2026, mirëpo për shkak të mundësive buxhetore nuk kanë pasur mundësi me realizuar dhe është për tri vjet kurse punimet kanë filluar me procedurë.

Burim Paçarizi (GP. PDK): Unë e kam parë një lajm lirimi i digës. A është Drejtori i Inspektoriatit aty?

Blerim Thaçi (Drejtor për Ekonomi dhe Financa): Unë shumë kisha dashur me qenë një formë e Kontratës Kolektive, një formë e realizimit të Kontratës Kolektive, ju e dini shumë mirë që pothuaj se të gjitha komunat kemi qenë në protestë për atë punë. Ne jemi të ngulfatur100% në realizimin e shpenzimit të buxhetit, sikur të mos kishin qenë 5.5 milion euro shtesë nga të hyrat vetanake ne do të ishim në kolaps në projekte, ne kemi i kemi mbuluar ato humbje sepse nuk do të kishim mundur me i realizuar të gjitha ato kërkesa që janë, ne do të mundohemi prapë me inkasuar dhe të realizohen ndoshta jo të gjitha kërkesat, por të paktën disa prej tyre.

Enver Hoti (GP. AAK): Pse ju si qeveri me ju dërgu kërkesë dapartamentit të buxhetit atje ose të Ministrisë së Arsimit, kur ju duhet me adresuar se e keni kompetencën e plotë në Komisionin për Buxhet dhe Financa në parlament? Kur të gjitha organizatat buxhetore i drejtorojnë kërkesat e tyre në Komisionin për Buxhet dhe Financa në parlament e ke gabuar rrugën. Ai komision për buxhet dhe financa pozitë dhe opozitë bashkë me Ministrat e Financave e vendosin çështjen, jo zyrtarët nëpër institucione të tjera. A ka mundësi me na rradhitur cilat janë ato çështje brenda Kontratës Kolektive, që po e penalizojnë buxhetin tonë? Pse duhet me shkuar çështja e Kontratës Kolektive në përmbarim kur e dinë që rritet kostoja e investimit?

Që pesë vite jeni duke folur për këtë çështje, për çdo vit keni me pasur çështje të tilla me të cilat keni me ngarkuar buxhetin dhe ju kanë zhvendosur nga fokusi i zhvillimit komunal. Ne nuk jemi duke ju akuzuar, por jemi duke kërkuar veprime dhe vendime konkrrete paraprake të cilat e rregullojnë këtë çështje, jo me mbetë për çdo ditë dyerve të gjykatës, kjo është e rëndë për mësimëdhënësit sepse ata nuk i marrin ato pagat kompletë sa i meritojnë sepse aty pak ia merr avokati dhe pak përmbaruesi dhe kur vjen në fund humbin mësimëdhënësit dhe komunat. Gjykata e ka cekur që këto janë obligime të komunës dhe shtrohet pyetja: pse nuk janë kryer? Më mirë është një projekt më lënë më pak dhe me realizuar këtë çështje, ta gjejmë një zgjidhje dhe ta liriojmë buxhetin e komunës. I gjithë problemi është te planifikimi i buxhetit.

Ekrem Kastrati (Kryetar i Komunës): Ju faleminderit të gjithëve për kontributin tuaj.Secili prej juve por edhe unë që jam këtu kemi ardhur në bazë të vullnetit të qytetarëve dhe unë e kuptoj shqetësimin e secilit prej juve. Ne kur e kemi bërë planifikimin e buxhetit i kemi analizuar shumë të gjitha kërkesat dhe nevojat e të gjithë qytetarëve. Shtatorja e Adem Jasharit dhe Monumenti i Lirisë i mungojnë Sheshit të Dëshmorëve, këto nuk janë parashikuar në projektin që është realizuar sepse kemi dashur që përmes një procedure të veçantë, përmes një konkursi publik t'i ftojmë të gjithë arkitektët, apo të gjithë ata që kanë ide për një monument të lirisë në Sheshin e Dëshmorëve dhe aty është cekur një shumë e përafërtë dhe jo shumë e saktë statike. Projekti Maisheva Urbane nuk ka me përfunduar asjëherë. Në asnjë komunë të Kosovës nuk e kanë Organizatën e Veteranëve të dalura nga Lufta të cilën e ka komuna e Malishevës pothuajse çdo vit i mbështesim me shumën financiare prej 10.000.00 € dhe ne mundohemi me i mbështetur gjithmonë që ata me funskionuar sa më mirë. Ne do të mundohemi me i diskutuar të gjitha çështjet edhe në periudhat e tjera, bashkëpunimi do të jetë me opizitë, sepse për mua është objektiv i kohës është objektiv i përditshëm i punës tonë në zyre, prandaj është mirë edhe ju me ardhë në zyëen time sepse mundësia e sqarimit të kërkesave kur jeni në zyrë dhe objekte tona është shumë më e madhe. Faleminderit!

Kryesuesi i Kuvendit e vuri në votim: Shqyrtimin dhe miratimin e draftbuxhetit për Komunën e Malishevës 2027/2029, me theks të veçantë për vitin 2027
Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se me shumicën e votave të anëtarëve të Kuvendit u miratua draftbuxheti i Komunës së Malishevës 2027/2029, me theks të veçantë për vitin 2027-të.
Rezultati i votimit:14 **për**, **kundër** 9, **abstenim** 1.

Fatmir Ademaj (Kryesues i Kuvendit): Urime qytetarë të Komunës së Malishevës!

Pauza:13:00
Filloi: 14:00

6) *Shqyrtimi i Raportit të auditimit për Pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Malishevës për vitin 2025, i Zyrës Kombëtare të Auditimit.*

Fatmir Ademaj (Kryesuesi i Kuvendit): Hapi debatin për këtë pikë të rendit të ditës.

Veton Zogaj (GP. LVV): Raporti i Auditimit është dokumenti bazë që e tregon, në mënyrë konkrrete dhe analitike, komplet modelin qeverisës të një qeverisjeje komunale. Unë do të mundohem t'i përmbledh në pika të shkurta disa çështje, për të cilën unë nuk e di a mund me marrë përgjigje prej drejtorit ose të paktën do të ishte mirë me qenë prezent Kryetari, meqenëse kërkojnë trajtim edhe prej anës së tyre. Në këtë Raport të Auditimit komuna e Malishevës nuk ka dalë mirë. Prej 19 rekomandimeve që i kemi pasur nga Raporti i vitit 2024,18 prej tyre fare nuk janë marrë për bazë në komunë, dhe fare nuk është vërejtur inpakt i komunës për të përmirësuar gjendjen të cilën aty është vërejtur shkelje ose tejkalim i kompetencave të qeverisjes komunale. Pastaj i kemi shkeljet sidomos te fushave e financave të llogaritura janë 974.000.00 € do me thënë projekte të cilat janë realizuar prej komunës që kapin vlerën afër një milion euro fare nuk janë shënuara nëpër libra apo formularë të deklarimit të cilat i kërkon standardi i Auditimit nga ana e ZKA-së. Janë rregjistruar 19 pagesa për kategoritë e gabuara ekonomike që kapin vlerën mbi gjysmë milion euro, të cilat janë kryesisht vendime gjyqësore të cilat janë të arsyetuara për shkak të zbatimit të Kontratës Kolektive. Pasuritë e parregjistruara janë mbi 1.700.000,00 € kjo është shumë shqetësuese, pastaj janë pasuritë jokapitale janë 271.000.00 € që janë gjetur nga Raporti i Auditimit. Detyrimet kontigjente janë paraqitur gabime në vlerën prej 266.000.00 €.J anë gjetur 19 ndryshime buxhetore pa aprovim të Kuvendit të cilat e kapin shifrën prej 805.000.00 € kjo shumë është shumë shqetësuese, ne e dimë që asnjë aprovim buxhetor nga ana e Kryetarit dhe as nga ana e drejtorive nuk mundet me u bërë në Kuvend pa u bërë nga miratimi i Kuvendit, ndërsa 19 raste i ka vërejtur Auditori. Me vonesë janë paguar 27 fatura pas tridhejtë ditësh, ligji e përcakton që secila faturë duhet me u paguar brenda afatit prej tridhjetë ditësh të cilat e kapin vlerën prej 767.000.00 €. Janë lidhur 3 kontrata pa fonde monetare, të cilat e kapin shifrën prej gjysmë milioni euro. Janë paguarë 30.000.00 € në një marrëveshje bashkëpunimi azhorim pa obligm të kjartë dhe pa prokurim do me thënë komuna ka lidhur një kontratë pa procedura tenderuese. Tender pa projkt ekzekutiv për rrugën te ujëvara e Mirushës, ne e dimë që këto mjete janë të nivelit qendror, janë afërsishtë mbi gjysmë million euro, ndërsa komuna e ka realizuar këtë projekt pa i pasur mjetet e ekzekutura. Pishina e Banjës e ka pasur një tarifë prej 3 € për meterë katrorë në vend të 4 € për meter katror do me thënë komuna nga kontrata e operatorit që e ka pasur në shfrytëzim për 2 vitet paraprake i ka humbur afërsishtë mbi 5.147 € e cila bie në kundërshtim me Kontratën që e kemi lidhur si komunë. Te procesi i rekrutimit janë vërejtur gabime.Te projektet kapitale 6 projekte janë realizuar me vonesë. Ajo çfarë mbetet shqetësuese për mua është aspekti financiar që kryesisht janë gjetur në fushën e financave dhe komuna e Malishevës nuk e ka shqyrtuar fare Raportin e vitit 2024.

Blerim Thaçi (Drejtor për Ekonomi dhe Financa): Ministria e Financave e ka propozuar një kod 40 që mjetet që do të shpenzohen për lëndë përmbarimore të dedikohen për atë kod dhe ato mjetet me shkuar subficit nëse nuk ka vendime gjyqësore. Te detyrimet kontigjente përveç lëndëve gjyqësore që i ka avokati i komunës i kemi edhe disa detyrime kontigjente në të cilën ngarkohet komuna nga taksat e bizneseve prej vitit 2000 e tutje, AZHR-ja nuk funksionon ajo ka qenë një marëveshje sikurse që e kanë pasur edhe komunat e tjera. Procedurat e prokurimit kanë filluar të zhvillohen, ndoshta pa totalin e zotimit të mjeteve dhe të projekteve, pasi që nuk ka pasur edhe operator projektues për projektet që është dashur me u zhvilluar procedura.Te çështja e lëndëve përmbarimore nuk do të ketë përmirësim derisa të shlyhet obligimi qoftë nga niveli qendror dhe nga procedurat gjyqësore nuk mund të përfundohet ai proces. Ju faleminderit!

7) Shqyrtimi i Raportit të performancës së Komunës së Malishevës për vitin 2025.

Fatmir Ademaj (Kryesues i Kuvendit): Fjalën ia kaloj Drejtorit për Administratë të Përgjithshme z. Argjend Thaçit.

Argjend Thaçi (Drejtor për Administratë të Përgjithshme): Faleminderit Kryesues!Të nderuar drejtorë, të nderuar anëtarë të Kuvendit. Më lejoni që në pika të shkurta ta paraqes para juve Raportin e performancës. Sipas vendimit të Kryetarit të Komunës të datës:17.08.2023 Nr.Pro.01/08/2023 është themeluar Komisioni për raportim në SMPK, i cili komisioni në afatin e paraparë ka raportuar në MAPL për 16 fushat e SMPK. Komuna e Malishevës në raportin e SMPK, në nivel vendi me 47% në nivel vendi e rradhitur në pozitën e tetëmbëdhjeta (18), ndërsa në rradhitjen te Grandit i performancës nuk jemi kualifikuar për shkak të pasojave që na i ka sjellë Kontrata Kolektive. Materialin të cilën e keni përpara e keni rradhitjen në formë tabelare. Ndërsa vlen të theksohet se fusha me performancën më të lartë është Planifikimi Hapësinor me 98.2 %, Kultur Rini dhe Sport me 87.6%, Kujdesi Primar Shëndetsor me 73.9%, Menagjimi i Fatkeqësive me 68.5%, Shërbime Publike Administrative me 65.3%, Shërbime Publike me 60%, Hapësirat Publike me 54.9%, Përgjegjshmëria Komunale me 53.9%, Mbrojtja e Mjedisit me 50%, Arsimi Parauniveristar me 50%, Transparenca Komunale me 32.5%, Barazia në Punësim me 24.7%, Përfaqësimi Gjinor me 17 %, Infrastruktura Rrugore me 16.7 %, Zhvillimi Ekonomik Lokal me 4.3%. Komuna ka respektuar kriteret për dokumentimin e të dhënave komunale të cilat janë në nivel të kënaqshëm të prezantimit të referencave të caktuara në formularët e raportimit brenda organeve komunale apo jashtë komunës nga ndërmarrjet publike komunale dhe institucioneve tjera lokale. Po ashtu komuna e ka përmbushur kriterin e raportimit për të gjithë treguesit e performancës komunale. Ndërsa mbesim me shpresë që këtë vit performanca komunale për vitin 2026 të jetë e një nveli më të lartë. Ju faleminderit shumë!

Fatmir Ademaj (Kryesues i Kuvendit): Faleminderit drejtor. Tani hapim debatin.

Veton Zogaj (GP.LVV): Neve nuk na gëzon aspak fakti që komuna e Malishevës ka dalë jo mirë në Raportin e performancës, në vitin paraprak kemi qenë përfitues të Grandit të performancës dhe kemi qenë të renditur shumë mirë, kurse tani nga tabela që e kam këtu figuron shumë poshtë e 25-ta komuna e Malishevës. Ne si Kuvend duhet me pa se cila është mundësia që ne me përmirësuar për vitet e ardhshme.

Halil Morina (GP. NISMA): Sot gjatë gjithë seancës është përmendur efekti i lëndëve përmbarimore që është shkaktuar nga Kontratat Kolektive e cila ka reflektuar edhe në Raportin e performances. Në raportin e ardhshëm nuk guxojnë me gjetur ato të meta që i kemi në këtë raport, ajo që është punë e jona do ta kryejnë, kurse ato të përmbaruesit nuk kemi çfarë t'i bëjmë në vazhdimiësi kanë me na ardhur në atë formë, derisa të përfundohen njëherë e mirë dhe të lirohemi prej saj.

Fatmir Ademaj (Kryesues i Kuvendit): Atëherë kush është për aprovimin e Raportit të performances?
Kryesuesi i Kuvedit konstatoi se me shumicën e votave të anëtarëve të Kuvendit e miratuan Raportin e performancës të Komunës së Malishevës për vitin 2025.
Rezultati i votimit:17 **për**, **kundër** 0, **abstenim** 7.

8) Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit të Kryetarit të Komunës së Malishevës, për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës së Malishevës në shfrytëzim afatshkurtër përmes ankandit publik, deri në 15 (pesëmbëdhjetë) vjet, për organizatat e shoqërisë civile me qëllim të organizimit dhe funksionalizimit të qëndrimit ditor për të moshuar, kuzhinës humanitare dhe qendrër për fëmijët me nevoja të veçanta shëndetësore.

Fatmir Ademaj (Kryesues i Kuvendit): Fjalën ia kaloj zyrtarit ligjor *z.Muharrem Morina.*

Muharrem Morina (Zyrtar ligjor): Përshëndetje për të gjithë! Në Kuvend është hera e tretë që është duke u diskutuar e njëjta çështje me të cilën po merret vendim dhe po shfuqizohet vendimi. Qëllimi është i mirë mirëpo procedura është e vështirë. Ky është një projekt me miliona euro nga shoqata "Jetimat e Ballkanit" me qëndrim ditor për të moshuar, kuzhinë humanitare dhe qendër për fëmijë me nevoja të veçanta shëndetësore. Ne së bashku me Kryetarin kemi qenë te donatori i kemi treguar për problemet ligjore të cilat jemi duke i hasur dhe ne kemi ardhur në përfundim që me shkuar me ankand deri në 15 vite, që me arritur me ndalur atë donacion në komunën e Malishevës, besoj që edhe Ministria do ta ketë parasysh që është një donacion i cili si pronë do të krijohet pronë publike në Kuvendin Komunal dhe ndërtesa do të rregjistrohet si aset i Kuvendit Komunal, ndërsa shërbimet do t'i kryejë Shoqata "Jetimat e Ballkanit" për kategorinë më të ndjeshme të shoqërisë sonë.

Fatmir Ademaj (Kryesues i Kuvendit): Të gjithë ne e kemi dhënë kontributin në dy mbledhjet e kaluara, rreth kësaj çështjeje, atëherë e vendosim në votim. Kush është *për*?
Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se me vota unanime nga anëtarët e Kuvendit u miratua propozimvendimi i Kryetarit të Komunës së Malishevës, për dhënien e pronës së paluajtshme të komunës së Malishevës në shfrytëzim afatshkurtër përmes ankandit publik, deri në 15 (pesëmbëdhjetë) vjret, për organizatat e shoqërisë civile me qëllim të organizimit dhe funksionalizimit e qëndrimit ditor për të moshuar, kuzhinës humanitare dhe qendrës për fëmijë me nevoja të veçanta shëndetësore.
Rezultati i votimit: 20 **për**, **kundër** 0, **abstenim** 0.

9*) Formimimi i Komisionit vlerësues me rastin e dhënies në shfrytëzim të pronës publike përmes ankandit publik deri 15 (pesëmbëdhjetë) vjet.*

Kryesuesi i njofton anëtarët e Kuvendit se duhet të formohet një Komision dhe i fton që të propozojnë emërat e kandidatëve për anëtarë të komisionit.
Fitim Shala (GP.LDK): Unë për këtë komision propozoj ***znj.Xheneta Morina.***
Halil Morina (GP. NISMA):Unë në emër të grupit Nisma e propozojë ***z.Skender Zogaj.***

Kryesusi i Kuvendit konstatoi se me shumicën e votave u miratua propozimi që anëtarë të *Komisionit vlerësues* me rastin e dhënies në shfrytëzim të pronës publike përmes ankandit publik deri 15 (pesëmbëdhjetë) vjet, anëtarë të Komisioniet të jenë ***znj.Xheneta Morina*** dhe ***z.Skender Zogaj.***
Rezultati i votimit: 13 **për**, **kundër** 0, **abstenim** 7

10) Shf*uqizimi i Vendimit nr.02/230, dt.29.07.2026, konform shkresës nr.02/4438-2/26, dt.31.08.2026, të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit hapësinor, në lidhje me miratimin e kërkesës nr.01/12/15, dt.08.01.2026, të parashtruar nga KRM "Ekoregjioni" sh.a në Prizren.*

Kryesuesi i Kuvendit pasi konstatoi se nuk ka të lajmëruar për diskutim e vuri në votim.
Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se me vota unanime nga anëtarët e Kuvendit, shfuqizohet Vendimi nr.02/230, dt.29.07.2026, konform shkresës nr.02/4438-2/26, dt.31.08.2026, të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit hapësinorë, në lidhje me miratimin kërkesës nr.01/12/15, dt.08.01.2026, të parashtruar nga K.R.M "Ekoregjioni " sh.a në Prizren.
Rezultati i votimit: 20 **për**, **kundër** 0, **abstenim** 0.

11) *Rishqyrtimi i Vendimit të Kuvendit të Komunës së Malishevës, nr.02/224, dt.22.07.2026, në lidhje me inicimin e procedurave administrative për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës publike deri në 15 vjet përmes procedurës së ankandit publik.*

Kryesuesi i Kuvendit pasi konstatoi se nuk ka të lajmëruar për diskutim e vuri në votim. Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se me vota unanime nga anëtarët e Kuvendit, RishqyrtohetVendimi i Kuvendit të Komunës së Malishevës, nr.02/224, dt.22.07.2026, në lidhje me inicimin e procedurave administrative për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës publike deri në 15 vjet përmes procedurës së ankandit publik.
Rezultati i votimit: 20 **për**, **kundër** 0, **abstenim** 0.

12) *Rishqyrtimi i Vendimit të Kuvendit të Komunës së Malishevës, nr.02/226, dt.22.07.2026, për formimin e Komisionit Vlerësues për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës publike deri në 15 vjet përmes procedurës së ankandit publik.*

Fatmir Ademaj (Kryesues i Kuvendit): Në kuadër të saj bëhet edhe rikonfirmimi i komisionit, i cili ka qenë. Kush është *për*?
Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se u miratua propozimi për rikonfirmimit të komisionit.
Rezultati i votimit: 20 **për**, **kundër** 0, **abstenim** 0.

13) *Rishqyrtimi i Vendimit të Kuvendit të Komunës së Malishevës, nr.02/225, dt.22.07.2026, Vendimi përfundimtar për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës së Malishevës përmes procedurave të shprehjes së interesit publik.*

Fatmir Ademaj (Kryesuesi i Kuvendit):E ftojë zyrtarin ligjor për interpretim ligjor.

Muharrem Morina (Zyrtar ligjor): Me rastin e pranimit të shkresës së Ministrisë, ne ju kemi drejtuar me kërkesë zyrtare Mazreku Farm që ai me specifiuar cilat janë parcelat që dëshironë me i marrë në shfrytëzim për shkak që Kuvendi ka marrë vendim dhe ia ka ndarë shtatë parcela, mirëpo nuk e ka specifikuar për cilat parcela. Nëse ju e miratoni kërkesën e operatorit, atëherë specifikohen parcelat e tokës.

Halil Morina (GP. NISMA): Ne si komision e kemi kryer punën tonë, mendoj që Drejtoria e Gjeodezisë duhet me dalë në terren dhe ta bëjë një skicë të qartë, unë i kam parë në Gjeo Portal ato janë parcela të cilat janë shumë të mëdha, pastaj formën se si i ka kërkuar operatori ekonomik për mua është pak e çuditshme është jokompakte, sepse parcelat nuk janë të lidhur njëra me tjetrën. Unë propozoj që këtë vendim me shfuqizuar, por jo përfundimisht sepse unë nuk jam që mos me lejur për me dhënë në shfrytëzim këtë pjesë, por me saktësuar mirë, komisioni me vazhduar punën e vet dhe ne me ardhur me një vendim të ri që e specifikojmë. Unë kisha kërkuar nga anëtarët e Kuvendit, edhe në cilësinë e anëtarit të këtij komisioni me shfuqizuar këtë vendim, dhe pasi që të vijmë me një vendim të ri me vazhduar më tutje.

Bashkim Krasniqi (GP.NISMA): Kryesues sa i përket kësaj pike, unë nuk e di kur ka ardhur konfirmimi apo mos konfirmimi nga Ministria edhe ka kërkuar sqarime. Mirëpo unë besoj që nuk merr shumë kohë, mirë që komisioni e ka rekomanduar kërkesën te përfituesi në këtë rast dhe ai është dashur me specifikuar saktë përmes matjeve dhe jo me i ndarë parcelat sepse nuk e dimë a realizohet komplet për dhënie në shfrytëzim apo jo, por përmes gjeodetëve mund të specifikohet, përmes hartave, kordinatave cila është pjesa që ai ka me marrë dhe sado me pasë një hartë apo skicë për ta ditur se çfarë jemi duke dhënë në shftytëzim, për për çfarë jemi duke e ngritur dorën këtu. Në këtë formën përmendësh, unë nuk jam për ta votuar në këtë mbledhje, unë jam për me shtye, në mënyrë që të plotësohet me manuale gjeodezike dhe pastaj të na vie edhe numri i propozuar se çfarë numri ka me pasur parcela pasi që të ndahet sepse mundet parcela me pasë edhe numrin si propozim. Se cilin numër do ta marrë parcela dhe unë a do ta ngrisë dorën për numrin një apo dy. Në shkresën e Ministrisë te arsyetimi është cekuar se aty numrat janë ndryshuar dhe se nuk janë duke i kuptuar edhe ne dëshirojmë me ditur se çka jemi duke votuar.

Burim Paçarizi (GP. PDK): Unë i bashkangjitem arsyetimit të kolegëve, të gjitha ato që i cekën janë reale të cilat vërehen edhe në material. Unë kërkojë që kjo kërkesë të vjen me numra të saktë të parcelës, jam duke e vërejtur që dy parcela janë pjesërisht dhe në momentin që e lejon mundësinë e dyshimit brenda parcelës, secili do shftytëzues, mund të shfrytëzojë pa e specifikuar. Unë kërkojë që secila parcelë të jetë me fleta poseduese dhe me kopje të planit dhe ato parcela të cilat do të shfrytëzohen pjesërisht duhet me i sjellë me raport të gjeodetit të licensuar.

Halil Morina (GP. NISMA): Unë propzoj që me u shfuqizuar vendimi fillestar që e ka marrë Kuvendi dhe komisioni me i kryer punët e veta.

Muharrem Morina (Zyrtar ligjor): Ne jemi në një proces që vendimi është në gjysmë të rrugës, aty janë ndarë shtatë hektarë toke, mirëpo Ministria ka kërkuar që ato të precizohen.Precizimi bëhet në mënyrën më të mirë të mundshme ashtu siç e ceku z.Bashkimi, sepse duhet me pasur manualin e gjeodezisë me i bërë draft hartat, pastaj me miratuar në Kuvend, pastaj ekzekutohen në terren dhe në kadastër, por gjithmonë duke e pasur parasysh që ato janë në shfrytëzim.

Halil Morina (GP. NISMA): Nëse ne sot e shfuqizojmë nuk rrezikojmë asgjë në MAPL, sepse pas dhjetë dite mundesh prapë me marrë një vendim nëse i plotëson ato kritere që kërkohen, sepse nuk shfuqizohet vendimi i komisionit por vetëm vendimi i Kuvendit.

Fatmir Ademaj (Kryesuesi i Kuvendit): Kush është për shfuqizimin e vendimit?

Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se me vota unanime nga anëtarët e Kuvendit shfuqizohet Vendimi i Kuvendit të Komunës së Malishevës, nr.02/225, dt.22.07.2026, Vendimi përfundimtar për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të komunës së Malishevës përmes procedurave të shprehjes së interesit publik.

Rezultati i votimit: 20 **për**, **kundër** 0, **abstenim** 0.

14) *Rishqyrtimi i Vendimit të Kuvendit të Komunës së Malishevës, nr.02/221, dt.22.07.2026, Vendimi përfundimtar për dhënien në shfrytëzim afatgjatë deri 30 (tridhjetë) vjet, të pronës së paluajtshme të komunës së Malishevës për subjektin afarist " Pashtriku " me menaxher drejtues z.Afrim Gigollaj.*

Kryesuesi i Kuvendit pasi që konstatoi që nuk ka të lajmëruar e vendosi për shfuqizim.
Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se me vota unanime nga anëtarët e Kuvendit, shfuqizohet Vendimi i Kuvendit të Komunës së Malishevës, nr.02/221, dt.22.07.2026, Vendimi përfundimtar për dhënien në shfrytëzim afatgjatë deri 30 (tridhjetë) vjet, të pronës së paluajtshme të komunës së Malishevës për subjektin afarist " Pashtriku " me menaxher drejtues z.Afrim Gigollaj.
Rezultati i votimit: 20 **për**, **kundër** 0, **abstenim** 0.

15) *Shqyrtimi i Raportit të Komisionit të formuar sipas Vendimit, nr.01/1590, dt.11.09.2026*

Fatmir Ademaj (Kryesues i Kuvendit): Fjalën ia kaloj zyrtarit ligjor.

Muharrem Morina (Zyrtar ligjor): Këtë vendim e ka marrë Kryetari dhe e ka formuar komisionin, për këtë Raport edhe ju e keni materialin. Operatori ekonomik Edorrita e ka paraqitur një kërkesë pranë organeve të Kuvendit Komunal, për shkak të planifikimeve që i ka në atë parcelë, kërkon që me miratimin e Kuvendit Komunal me ia zgjatur afatin e shfrytëzimit të parcelës për shkak që në vitin 2035 i përfundon afati dhe sipas kërkesës së palës në këtë rast, për shkaqe të sigurisë me bashkëinvesitorët, ata kanë kërkuar që me pasë një afat më të gjatë të shfrytëzimit. Ne së bashku me z.Fadil Shalën dhe z.Armend Krasniqin e kemi bërë një raport të cilën ju kemi dorzuar juve. MAPL-ja në bazë të vendimit të cilin e merrni ju, ata pastaj na dërgojnë konfirmimin e ligjshmërisë.

Demir Bajra (GP. PDK): A na lejohet neve me votu nëntë vjet para kohe siç po kërkohet? A jemi duke dalë serioz si Asamble këtu?
Muharrem Morina (Zyrtar ligjor): Ju e lexoni dhe e shqyrtoni kërkesën pse e ka bërë dhe pastaj me vullnetin e tuaj vendosni për kërkesën në fjalë, asnjë dispozitë ligjore nuk e thotë në mënyrë decidive që e ndalon ajo që po kërkohet prej operatorit, në anën tjetër nuk e thotë ligji që lejohet ajo që po e kërkon.
Veton Zogaj (GP. LVV): Këtë çështje e kemi pasur edhe në KPF, unë e konsideroj që nëse ne e marrim një vendim të tillë, e marrim vetëm me hamendësim dhe nuk e dimë se çfarë sjellë e ardhmja. Me vendosur sot se çfarë ndodh pas nëntë vitesh, jo vetëm qe na qetë në lajthitje, realisht hap edhe shunë fronte që me na u kontestuar vendimi jonë. Ne tek kërkesa e operatorit ekonomik mundemi me ia pranuar vetëm atë pjesën që ka kërkuar me ia ulur qiranë, te ajo pjesë e parcelës që ju ka marrë, mos me obliguar qiranë ndaj komunës, ne vetëm këtë vendim mundemi me marrë.

Në aspektin tjetër për t'ju vazhduar kontratën për nëntë vjet ne bëjmë shkelje ligjore. Nëse e ndan si kërkesë operatori ekonomik, kërkon që me ia ulur qiranë për atë pjesën e parcelës që ju ka marrë, atëherë jemi pro, përndryshe ne nuk e votojmë sepse e dim që aty ka investime edhe komuna. Kuvendi komunal e ka marrë një vendim që atë pjesë me dhënë në shfrytëzim për diçka tjetër dhe çfarë do që bëjmë aty vetëm se e ngarkojmë në proces.

Kryesuesi i Kuvendit e vuri në votim Raportin e Komisionit të formuar sipas Vendimit, nr.01/1590, dt.11.09.2026.
Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se me shumicën e votave nga anëtarët e Kuvendit u miratu Raporti i Komisionit të formuar sipas Vendimit, nr.01/1590, dt.11.09.2026.
Rezultati i votimit: 17 **për, 3 kundër**, **abstenim** 0.

16) *Shqyrtimi i kërkesës nr.02/201, dt.10.07.2026, e parashtruar nga z.Ardian Aziz Telaku nga fshati Banjë, Komuna e Malishevës, për këmbimin e pronës private me pronë publike.*

Fatmir Ademaj (Kryesues i Kuvendit): Hap diskutimin

Halil Morina (GP. NISMA): Ne këtë kërkesë e kemi vetëm me një dokument dhe për me shtyer këtë pikë duhet me bërë të qartë se cilat dokumente duhet me i sjellë pala që ne me trajtuar,është mirë me specifikuar konkretisht se çfarë me sjellë pala prej dokumenteve.

Muharrem Morina (Zyrtar ligjor): Kjo kërkesë është e palës private dhe unë nuk jam duke dalë këtu me autorizimin e askujt. Lënda ka qenë e kompletuar dhe pala kërkonë me bërë këmbimin e pronës private me pronën publike. Procedurën që duhet me zhvilluar në rastin konkrret është e ligjshme. Pala e ka ndërtuar shtëpinë para luftës në pronën publike, afërsisht dyzetë vjet, tani ose me shkuar dhe me rrënuar atë shtëpi dhe me lënë një familje pa banim, ose kemi me ia mundësuar me legalizuar, ligji aktual na lejon që me hy me këmbim. Kërkesa ka bazë ligjore.

Veton Zogaj (GP. LVV): Pronari i cili e ka atë shtëpi është e vërtetë atë që e tha z.Muharremi sepse ai e ka marrë shumë kohë më parë për qëllim të shfrytëzimit dhe ai aty ka ndërtuar pa leje dhe kjo është uzurpim i pronës publike dhe duhet me u trajtuar kjo çështje sepse komuna nuk ka përfituar asgjë prej pronarit. Ne duhet me trajtuar si objekt pa leje. Pronën të cilën e ka ai është në zonë urbane. Pronën që dëshiron me dhënë për këmbim ai ndoshta e ka në Gajrak. Çfarë i hynë në punë ajo pronë komunës?

Halil Morina (GP. NISMA): Në parim kjo kërkesë është e ligjshme, mua më ka ardhur vetëm një fletë, kurse kolegët ma treguan kërkesën e plotë. Propozoj Kryesues që me themeluar një grup në what's up dhe aty me u njoftuar të gjithë anëtarët, nëse dikujt nuk i ka shkuar materiali me ia dërguar prapë. Ne sot nuk po marrim vendim me këmbyer pronë, ne sot vetëm po e hapim

procedurën dhe Ministria e Financave ka me bërë vlerësimin, ne nuk e dimë ajo prona private të cilën e ka propozuar pala me këmbyer me pronën publike që nuk i hyn në punë komunës së Malishevës. Ne e dimë si është situata dhe ne nuk dëshirojmë me ardhur deri te rënimi sepse nuk është duke e penguar ndonjë projekt të rëndësishëm të komunës dhe as nuk parashihet ndonjë projekt i rëndësishëm për komunën sepse përndryshe ne nuk e kishim legalizuar, por e kishim shpallur si ozurpator.Tani meqenëse ekziston interesi i dyanshëm. Pse mos me bërë këtë punë ne? Unë propozoj që ta votojmë këtë vendim fillestar dhe pastaj ka me shkuar me u vlerësu nga Ministria e Financave dhe prapë ka me ardhur në votim përfundimtar te ne.

Remzi Hoti (GP.NISMA): Ka raste të shumta si e palës në fjalë, ne i kemi edhe tri vite në Asamble dhe me na u drejtuar neve qytetarët e komunës së Malishevës 80% duhet me jua ndëru pronat. Unë mendoj që është në konflikt direkt me qytetarin këtë rast me Asambleista, sepse në fshatin Carrallukë 80% i kanë shtëpitë në pronë publike, ne nuk e dimë vlerën e asaj prone të cilën ka me dhënë z.Adriani. A i ka ajo pronë vlerën 5 euro apo jo, apo është një zonë shumë të largët që as kafshët nuk jetojnë? Unë jam kundër dhe votojë kundër, sepse është direkt në konflikt me qytetarin këtë rast me Asambleistat.Unë nuk jam për me ia rrënuar shtëpinë, por jo me votuar.

Veton Zogaj (GP. LVV): Unë nuk thashë me ia rrënuar shtëpinë dhe nuk është mirë me devijuar bisedën. Ai le të jetonë sikur që ka jetuar deri sot, vetëm të trajtohet si objekt pa leje.

Demir Bajra (GP.PDK): Ne nuk jemi persona kompetentë që e bëjmë vlerësimin e pronës. Ne si Kuvend kur kemi mundësi me i ndihmuar një familje për me bërë ndrrim, unë nuk jam për me stopuar. Unë nuk e njoh palën personalisht, nëse ne kemi mundësi me votuar e votojmë.

Bashkim Krasniqi (GP.NISMA): Kërkesa pa dyshim që është e ligjshme për shkak që ligji e lejon me bërë kërkesën dhe përveç komuna që ka drejtë me bërë këmbimin e pronës edhe personat fizik dhe personat juridik mund të bëjnë kërkesën e thotë neni 25 i ligjit për këmbimin e pronës së paluajtshme, mirëpo e thotë që është e domosdoshme që nga ky këmbim të arrihet interesi i komunës. Unë e kam cekur edhe në disa mbledhje të tjera, pa marrë parasysh që qytetarët i drejtohen Kuvendit, duhet të jetë një filtër i kërkesave dhe në këtë rast është dashur me na ardhur edhe një shkresë përcjellëse që e arsyeton interesin publik që e realizion komuna me këmbimin e kësaj prone dhe jo me ardhur vetëm kërkesa e palës. Pala supozohet që nuk e dinë se si bëhet një kërkesë, duke mos ia bashkangjitur dokumentet e nevojshme, duke mos ditur se në cilat dispozita ligjore duhet me u thirrur një kërkesë apo një lëndë për me u bërë këmbimi i pronës publike me pronën private.Të gjithë kanë të drejtë me paraqit kërkesë, ka kërkesa të cilat munden me u realizuar këmbimi i pronës dhe nuk munden me u bërë të gjitha të njëjta, mirëpo në interesin public mundemi me votuar çdo ditë dhe në mbledhjen e ardhshme me u marrë prapë me rishqyrtim të vendimeve tona, sikur që jemi duke u marrë sot nuk është problem, i votojmë këtu dhe në mbledhjën e ardhshme i shfuqizojnë, kështu do të shkojmë. Mendoj që nuk është në rregull, përderisa kemi mundësi me i përmirësuar.

Halil Morina (GP. NISMA): Ne këto raste kur i kemi nuk është mirë me trajtuar individin, por duhet me pasur parasysh çështjen. Ne sot e marrim vendimin, Ministria e bën vlerësimin dhe në fund nëse ajo tokë që ka me dhënë për këmbim nëse nuk ka interes komunal, atëherë ne mundemi me votuar kundër.
Fatmir Ademaj (Kryesues i Kuvendit): Meqenëse nuk ka më të lajmëruar për debat, atëherë e vendosim për votim. Kush është *për*?
Kryesuesi i Kuvendit konstatoi se me shumicën e votave nga anëtarët e Kuvendit miratohet Kërkesa nr.02/201, dt.10.07.2026, e parashtruar nga z.Ardian Aziz Telaku nga fshati Banjë, Komuna e Malishevës, për këmbimin e pronës private me pronë publike.
Rezultati i votimit: 12 **për**, **kundër** 3, **abstenim** 6.

17) *Të n d r y s h m e*

Fatmir Ademaj (Kryesues i Kuvendit): Drejtori i Inspektoriatit *z.Jakup Gashi* e ka kërkuar fjalën.

Jakup Gashi (Drejtor i Inspektoriatit): I nderuar Kryesues, të nderuar asambleistë! Meqenëse u ngrit çështja e digës më lejoni që ta them një sqarim në lidhje me çështjen. Kjo digë rrezikon këtë pjesë të fshatrave të komunës së Malishevës. Kryetari z.Ekrem Kastrati ka angazhuar ekspertë të fushës për çështjen e digës dhe ka ardhur me një konstatim sipas raportit të ekspertëve që e kanë ofruar për çështjen e digës, të cilat ndahen në diga të larta dhe diga të ulta me të cilën ne i referohemi raportit të cilën na kanë sjellë ekspertët për çështjen e digës. Sa i përket digës së Mirushës ajo hyn në grupin e digave të lëkunshme, gjerësia e digës është 7.60 metra dhe gjatësia 120 metra. Digat e ulta janë në objekt me lartësi deri në 15 metra nga diga më e ulët e digës e deri te kurora ose gjatësia e kurorës është deri në 500 metra dhe ajo mundet së paku me i pasur 100 mijë metra kub ujë, sasia e ujërva që duhet të evokojë është jo më tepër se deri më 200 mijë metra kub ujë. Ky objekt i takon grupit të digave të ulëta dhe sipas udhëzimit administrativ të Republikës së Kosovës numri 09/20 A neni 2 pika 1 dhe 1.1 dhe pika 1.2 neni 2 në këtë rast ky objekt nuk i nënshtrohet rregullave ligjore të digave të larta dhe është në kompetencë e nivelit lokal dhe jo e nivelit qendror.
Raporti i cili ju është ofruar kësaj organizate e cila është në mbrojtje të rrjedhave të lumenjve afërisht në gjatësi prej 5 km diga e Malishevës hyn në rradhët e saj dhe nuk duhet vlerësuar si digë e lartë, për ndikimin e saj pa dyshim që secili prej juve e di se ky akumulacion është ndërtuar që të bëjë akumulimin e ujit, i cili do të shfrytëzohet sipas nevojave të cilat munden të paraqiten në momentet e caktuara, por qëllimi është që kryesisht akumulacioni të shfrytëzohet për rekreacion dhe sport dhe në mungesë të reshjeve në raste të thatësirave të jashtëzakonshme ekstreme një sasi e ujit mund të përdoret edhe për nevoja në bujqësi për ujitje por dhe në raste të tjera dhe përfundimisht sipas raportit çfarëdo mase që ndërmeret këtu, duhet të konstatohet nga një grup ekspertësh profesionistë, prandaj sipas ekspertëve si autor i kësaj vepre, mendoj që ky objekt përveç disa tentimeve të vogla që është dashur të kryhen nuk paraqet asnjë rrezik për ambientin e tanishëm. Ky objek tani është pasuri e rrallë e cila duhet të ruhet dhe të ketë kujdesin e duhur për mirëmbajtje. Ne si qeverisje lokale këtë raport ia kemi dërguar me shkresë ministrisë dhe e kemi

informuar për çështjen e digës dhe ne si qeverisje lokale në asnjë formë nuk pranojmë që kjo digë të jetë në projektin e rënimeve të digave pa pasur një projekt tjetër që e dëshmon që pas rrënimit të saj do të ndërtohet.

Prandaj kërkoj nga ana e juaj dhe e të gjithë qytetarëvetë komunës së Malishevës, meqenëse ka krijuar një ambient të jashtëzakonshëm ndërtimi i kësaj dige ta mbështetin në çfarëdo forme dhe të mos lejomë që kjo digë të rrënohet për çfarëdo qëllimi të individëve të caktuar apo të grupeve politike të caktuara.

Fatmir Ademaj (Kryesues i Kuvendit): Ju faleminderit!

Mbledhja përfundoi punimet në ora ***15:37***.

Malishevë, më 29 shtator 2026

Procesmbajtësja

Fatlume Delija

Kryesues i Kuvendit

Fatmir Ademaj